

SPIRO FLOQI

PERIUDHA ME FJALI TË VARUR RRJEDHIMORE NË SHQIPEN E SOTME

Në këtë studim shqyrtojmë njësinë sintaksore të përbërë prej dy (ose më shumë) njësisish predikative, njëra prej të cilave tregon një pasojë, një rrjedhim a efekt të asaj që thuhet në njësinë tjetër. Veç mjeteve të tjera, si mjet kryesor i vartësisë së fjalisë shërbejnë lidhëzat. Një njësi e tillë e përbërë është quajtur prej nesh **PERIUDHË ME FJALI TË VARUR RRJEDHIMORE**. Në këtë periudhë nuk përfshijmë as konstruktet jopredikative (të ashtuquajturat fjali të pashtjella), as konstruktet predikative palidhëzore (a intonacionore): arësyet e një përcaktimi të tillë të objektit të studimit i kemi treguar në artikullin «Rreth disa çështjeve të fjalisë së përbërë në shqipen e sotme» (BISH, *Seria Shkencat Shoqërore*, viti 1955, Nr.3) si dhe në kumtesën e mbajtur në Konferencën e Parë Albanologjike «Mbi disa tipe semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur në shqipen e sotme» (botuar si broshurëzë me shaptillograf, kurse tani ndodhet në shtyp, në përmbledhjen e materialeve të kësaj konference).

Për gjuhën shqipe ky është i pari studim i veçantë për periudhën me fjali të varur rrjedhimore. Deri tani kemi pasë vetëm pjesët përkatëse të sintaksave shkollore, duke filluar nga «Sintaksa shqip» e prof. A. Xhuvanit (i cili, me sa duket, u ka pasë vënë dhe emrin këtyre fjalive të varura)¹. Ndërsa Ilia Dilo Sheperi nuk përmend ndonjë «fjali rrjedhore» në veprën e vet,² J. Rrota në tekstin shkollor «Syntaksa e gjuhës shqipe»³ dallon fjalinë rrjedhore, të cilën e trajton shkurt, sidhe më pas prof. K. Cipo në veprën *Sintaksa*⁴. Shkurt e trajton për nevojat e shkollave të mesme prof. M. Domi⁵, ndërsa më gjërë nga të gjithë doc. S. Prifti në dispensën për Institutet Pedagogjike Dyvjeçarë⁶.

Ndonëse gjithë autorët e lartpërmendur kanë dhënë kontributin e vet mbi atë të parashkuesve, qëllimi thjesht shkollor i paraqitjes ka lenë shumë boshllëqe në trajtimin e kësaj teme, të cilës ne po i

1) A. Xhuvani. *Sintaksa shqip*, pjesa e dytë, Tiranë 1934, fq. 41 «Fjalitë rrjedhore kallëzojnë një përfundim, një rrjedhje të punës që tregohet në fjalinë e parë. Këto janë fjalish quhen rrjedhore...»

Emërtimi rrjedhimore që i kemi dhënë kësaj fjalie të varur i përgjigjet më drejt emërit rrjedhim, i cili është i vetëmi në përdorim sot.

2) Ilia Dilo Sheperi: *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*. Vlorë, 1927.

3) J. Rrota, *Syntaksa e gjuhës shqipe*, botim i dytë, Shkodër 1943.

4) K. Cipo, *Sintaksa*. Botim i Institutit të Shkencave, Tiranë 1952.

5) M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe*, pjesa e dytë, sintaksa. Botim i tretë. Tiranë 1957.

6) S. Prifti: *Sintaksa e gjuhës shqipe*. Dispensë për Institutet Pedagogjike Dyvjeçare. Pj. II, Tiranë 1962.

përvishemi duke u mbështetur mbi një material të gjërë faktik, prej Rilindjes e deri sot, si dhe me material folklorik.

Prej tipeve të tjera semantiko-strukturore, tipi rrjedhimor dallohet për nga marrëdhënia dhe nga struktura. Marrëdhënia e shprehur në këtë tip periudhe është marrëdhënie shkaku dhe pasoje, rrjedhimi, ku rrjedhimi i shprehur në të varurën është rezultat i një sasive të madhe të diçkaje, të shprehur në kryesoren (korelati *aq*), ose i një cilësie (korelati *i tillë*), të cilëve u përgjigjen përkitazi lidhëza *sa* dhe lidhëza *që*.

Nga elementet kryesore të strukturës një nga modelet e këtij tipi përputhet me periudhën me fjali të varur krahësore përqasore të barazisë, ku mund të ndeshet po ajo lidhëzë *sa* dhe po ai korelat *aq*, por dallohet për nga elemente të tjerë strukturorë, dhe pikërisht sepse ai ka në fjalinë kryesore një bërthamë përemërore [korelat + mbi-emër (*aq* i mirë), korelat + ndajfolje (*aq* mirë), korelat + emër (*aq* njerëz)], bërthamë përemërore që tipi krahasor i barazisë s'mund të ketë veç se kur fjalia e varur të ketë një kallëzues të njejtë (ose të kundërtë) pikëpamja leksikore, por kjo e dallon menjëherë këtë tip të fundit prej tipit rrjedhimor, sepse aty kemi barazi sasiore kurse këtu kemi sasi e rrjedhim.

Le të krahasojmë shembujt:

1) Tipi rrjedhimor: Ferdinandi ishte thyer në betejën e Sarnos's më 7 Korrik, 1460, dhe *ndodhej aqë keq, sa* e shoqja, Mbretëresha Isabella *kërkonte* ndihma nga besnikët në portën e kishës San Pietro Partive ne Napoli / NOLI : HeS (90)/.

Në këtë periudhë, gjendja fort e keqe financiare e Ferdinandit shprehur në kryesoren solli si rezultat veprimin e të kërkuarit të ndihmës në portën e kishës.

2) Tipi krahasor a përqasor.

a) Alfonsi i *dha* Skënderbeut(...) *aq të holla sa* *ishin të nevojëshme* për të financuar këtë ekspeditë. /NOLI : HeS/.

Këtu kemi përshtatëshmi sasiore midis sasisë së të hollave dhe madhësisë, shkallës së nevojës për të holla.

b) përshtatëshmi sasiore të dy veprimeve a gjendjeve, leksikisht të kundërta, a të ndryshme, si p.sh. :

Shqiptarët *u gëzuan* për disfatën Turke *aq sa* *ishin helmuar* për humbjen e Stambollit [NOLI : HeS² (81)].

Tipi rrjedhimor mund të ketë përputhje të pjesëshme me një nga tipet e periudhës së varur kohore, me atë që bashkohet nëpërmjet lidhëzës *sa*, e cila nuk mund të ketë, vërtet, korelat në fjalinë kryesore, por kur tipit rrjedhimor i mungon korelati (tipi korelativ mungesor), strukturat përputhen. Dhe me të vërtet le të shohim cila është vlera e së varurës në këto periudha.

Thirri *sa* u ngjir.

Priti *sa* u lodh.

Jashtë kontekstit këto periudha mund të interpretohen dymënyrash:

1) si fjali të bashkuara me marrëdhënie kohore, dhe pikërisht si një periudhë ku veprimi i fjalisë së varur tregon cakun fundor, pikën fundore të shtjellimit të veprimit kryesor, një pikë fundore në të cilën veprimi i së varurës e ndërpret veprimin e kryesores (= thirri gjersa

u ngjir,) të thirrurit vazhdoi deri në atë moment që filloi të çfaqet te ngjirurit.

2) si fjali të bashkuara me marrëdhënie shkakut e rrjedhimi; në kryesoren intensiteti i veprimit (si dhe shtrirja në kohë) sjellin pasojën në të varurën.

Tipet e tjerë të periudhës me fjali të varur rrjedhimore dallohen fare qartë ose nga vetë mjeti i lidhjes (lidhëzat e përbëra *aq(ë)sa*, *kështu që* lidhëza thjesht rrjedhimore) ose njëherazi nga mjeti i lidhjes dhe nga mënyra e foljes kallëzues së fjalizë së varur: lidhëza në mënyrë që dhe kallëzuesi në dëftore, gjë që e dallon nga tipi i periudhës me fjali të varur qëllimore, bashkuar me këte lidhëzë, nga fakti që këtu kallëzuesi është domosdo në lidhore. Në raste të tjera dalimi bëhet nepërmjet të tërësisë së mjeteve strukturore kryesore dhe të atyre të dorës së dytë si dhe të korelacionit të brendive reale të fjalive që përbëjnë periudhën (shih më poshtë § 3.5)

Ndonjë tip periudhe mund të mbështetet mbi strukturën e një tipi tjetër dhe në sajë të korelacionit të përmbajtjeve reale të fjalizë së varur dhe asaj kryesore mund të dalë një nuancë rrjedhimore si diçka suplementare, eventuale, si diçka potenciale që mund të bëhet aq më e qartë, sa më e qartë të jetë korelacioni i brendive (shih § 4)..

1. 0. Kështu, përbrenda periudhës me fjali të varur rrjedhimore do të dallojmë këto tri tipe, secila me nëntipet e veta, sipas faktit që:

1) rrjedhimi i shprehur nga fjalia e varur mund të ngjyrohet nga ndonjë kuptim anësor që shprehet në fjalinë kryesore; ose

2) rrjedhimi nuk ngjyrohet nga ndonjë nuancë e tillë por paraqitet «i thjeshtë», si një pasojë logjike, si një konkluzion i asaj që thuhet në fjalinë kryesore, ose

3) rrjedhimi është një nuancë suplementare që shtrohet mbi funksionin themelor të fjalizë së varur, dhe del krejtësisht në bazë të bashkëlidhjes së përmbajtjeve konkrete reale të fjalive të periudhës; marrëdhëniet midis fjalizë së varur dhe kryesores janë në radhë të parë përcaktore, etj. me një nuancë eventuale të rrjedhimit.

Këndeji rrjedhin edhe tri grupet e mëdha të periudhave me fjali të varur rrjedhimore, të cilat kanë dallime mjaft të theksuara edhe nga pikëpamja e elementeve kryesore të strukturës së periudhës.

1.0.1 Në grupin e parë përfshihen ato periudha me fjali të varur që kanë në fjalinë kryesore një element korelativ (një korelat) të mjetit të lidhjes (korelati në raste të veçanta mund të mos jetë në fjalinë kryesore, por ai mund të shtihet atje pa sjellë ndonjë ndryshim esencial në llojin e marrëdhënies të shprehura, dhe ndryshimi të jetë vetëm stilistiko-gjinor). Si korelatë të tillë përdoren rëndom fjalët *aq(ë)*, *kaq(ë)*, fjalë përemërore që funksionojnë sipas rrethanave ose si ndajfolje sasie (pranë foljeve, ndajfoljeve dhe mbiemërave) ose si mbiemëra përcaktonjës (pranë emërave). Fjalët *aq(ë)*, *kaq(ë)* dëftojnë pa e konkretizuar sasinë e një sendi, masën e shkallën e një cilësie a intensitetin e një procesi. Fjalët *aq*, *kaq* rrallë mund të funksionojnë dhe vetëm, por në më të shumtën e rasteve ato përcaktojnë një emër, një mbiemër ose një ndajfolje. Prandaj njesinë e formuar prej fjalëve *aq* ose *kaq* dhe fjalëve të përcaktuara prej tyre do ta quajmë

bërthama përemërore (sipas modelit: *aq njerëz, aq i madh, aq mirë*)⁷. Fjalja e varur konkretizon këtë përemër jo duke treguar sasinë reale të përemërit *aq, kaq*, por në mënyrë të tërthortë, duke treguar rrjedhimin. Për këtë arsye fjalia e varur nuk duhet të quhet «fjali e varur sasiore» (duke u vënë në një plan me funksionin e një plotësori të sasisë në fjali)⁸.

Tjetër korelat i rëndësishëm i mjetit të lidhjes është përemëri dëftor i cilësisë *i tillë, e tillë* (më rrallë *i atillë, i këtillë*) i cili përdoret pranë emërash si mbiemër përcaktonjës ose përdoret si kallëzuesor. Këta përemra dëftorë dëftojnë pa e konkretizuar një cilësi të emrit, cilësi që konkretizohet tërthorazi nga rrjedhimi i shprehur në fjalinë e varur.

Përemri dëftor *ai* (rrallë *ky*) në togfjalëshe emërore pranë emërash me kuptim të caktuar leksikor (dhe të kufizuar në numur, si *shkallë, gradë, pikë*, si edhe *ditë*) mund të jetë baza e një bërthame përemërore me kuptim pak a shumë frazeologjik.

Togu *gjer atje* (*deri atje*) përbën në raste të veçanta me disa folje të caktuara një bërthamë përemërore, me funksion të ngjajshëm me të lartpërmendurit.

Në disa tipe të tjera semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur rrjedhimore disa fjalë kuptimplote si *mjaft, shumë, tepër* zenë në fjalinë kryesore një pozitë korelati, por pa qenë plotësisht të tillë; duke ruajtur kuptimin e vet leksikor, ata përbëjnë një shtojcë suplementare të mjetit të lidhjes në fjalinë kryesore, një farë korespondenti nocional të mjetit të lidhjes.

Nuanca me të cilat ngjyrohet kuptimi i rrjedhimit të fjalisë së varur ka të bëjë ose me sasinë, masën, intensitetin **ose me cilësinë**, të dëftuara gjithëmonë në mënyrë të pakonkretizuar në fjalinë kryesore.

Ky grup përbën tipin korelativ lidhëzor-përemëror.

Rastet kur mungon korelati përemëror përbëjnë nëntipin që do ta quajmë *nëntipi korelativ mungesor lidhëzor përemëror ose më shkurt nëntipi korelativ mungesor*.

1.0.2. Grupi i dytë i peridhave me fjali të varur rrjedhimore përfshin ato periudha, në fjalinë kryesore të të cilave nuk ka dhe nuk mund të ketë ndonjë korelat të mjetit të lidhjes. Fjalja kryesore është relativisht e plotë nga struktura dhe nga kuptimi, vetëm intonacioni i periudhës, nëpërmjet të një uljeje shumë të madhe të tonit në fund të fjalisë së parë tregon se dy fjalitë janë akoma të bashkuara në një njësi sintaksore më të madhe. Fjalja e varur tregon një rrjedhim të «thjeshtë», pa ndonjë nuancë suplementare, si një rezultat logjik i brendisë së gjithë fjalisë kryesore. Ky tip dallohet edhe për mjetet e lidhjes së të varurës me kryesoren si lidhëza *që*, e cila s'mund të marrë korelat në kryesoren, dhe ndeshet në fragmente me karakter afek-

7) Termi «bërthamë përemërore» nuk tregon njësi sintaksore. *Aq(ë), kaq(ë)* quhen «përemërorë» për shkak të origjinës së tyre, por sot veprojnë ose si mbiemra përemërorë, ose si ndajfolje.

8) Shqyrtimi i konstrukteve adekuate të rusishtes si «periudhe me fjali të varur sasiore» сложноподчиненное предложение с придаточным меры и степени është përfaqësuar në disa tekste shkollorë të sintaksës ruse, por në këtë pikë **ne** jemi dakord me trajtimin që u bën gramatika akademike si «сложные предложения с придаточным следствия» (АН СССР „Грамматика русского языка“. том II, часть II, стр. 340-342.

tiv, në prodhime ligjërimore të gjuhës së folur dhe të letërsisë artistike që riprodhon atë nuancë stilistike afektive të stilit familiar popullor.

Në këtë grup periudhash përdoren edhe mjete lidhëse relativisht të reja si lidhëzat e përbëra *kështu që, në mënyrë që* si dhe lidhëza e përbërë *aq(ë) sa, kaqë sa*⁹, lidhëza tashmë të formuara dhe që veprojnë gjerësisht në fragmentet ligjërimore që karakterizojnë gjuhën e shkruar dhe sidomos prodhime stilistiko-gjinore të gjuhës së shkruar si prozën artistike dhe veprat e gjinive publicistiko-shkencore.

Në grupin e dytë të periudhave me fjali të varur rrjedhimore hyjnë tipet semantiko-strukturore *lidhëzore jokorelative*.

Fakti që fjalia e varur nuk konkretizon ndonjë korelat të fjalisë kryesore dhe që ajo ka të bëjë me gjithë brendinë e fjalisë kryesore shkakton një lidhuri më të dobët midis tyre; kjo lidhuri më e dobët shprehet në elemente të tillë të intonacionit të periudhës si karakteri i uljes së tonit në fund të fjalisë kryesore, në pauzën e gjatë midis tyre.

1. 0. 3

Grupi i tretë përfshin ato periudha që kanë një fjali të varur e cila bashkohet me kryesoren nëpërmjet të përemrit lidhor *që* (fort rrallë *i cili*, etj.), fjalia e varur ka të bëjë me një emër të fjalisë kryesore, të cilin e përcakton: nga struktura dhe kuptimi kryesor kemi një periudhë me fjali të varur përcaktore me nuancë rrjedhimore. Përcaktimi që i bëhet emrit, në një rast të dhënë konkret, në sajë të qartësisë së përmbajtjes reale mund të shoqërohet nga nuanca e rrjedhimit.

Gjuha shqip s'është një gjuhë që të mos shkruhet (...)

/SAMI FRASHËRI : Shqipëria⁶.../

Funksioni kryesor i fjalisë së varur është ai i përcaktimit¹⁰.

1. 1. Mjetet e lidhjes

Mjetet e lidhjes së të varurës rrjedhimore me kryesoren nuk dallohen për ndonjë larmi të madhe.

Dy janë mjetet kryesore: lidhëzat *sa* dhe *që*, e para me kuptim sasior dhe e dyta me kuptim ffillëzonzës. Prej këtyre lidhëzave të thjeshta kanë dalë në kohë të mëvonëshme lidhëzat e përbëra (shprehjet lidhëzore) *sa që*, e cila ka të njëjtën vlerë që ka edhe lidhëza *sa*, lidhëza *aqë sa* (*kaqë sa*) e cila, është përfutur nga ndodhia pranë e e pranë e korelatit *aq* ose *kaq* në fund të fjalisë kryesore dhe e lidhëzës *që* në fillim të fjalisë së varur, nëpërmjet të disemantizimit të kuptimit të dëftimit sasior të ndajfoljes përemërore *aq(ë)*, *kaq(ë)* në procesin e të cilit kanë marrë pjesë përmendja e një sasi konkrete në fjalinë kryesore; lidhëza *kështu që*, e përfutur nga përdorimi i

9) Asnjë nga parashkuesit tanë nuk ka vënë re egzistencën e këtyre lidhëzave të përbëra. Këto trajtohen për herë të parë prej nesh. Shih më poshtë.

10) Me gjerë, nuancat rrethana të periudhës me fjali të varur përcaktore i kemi trajtuar në një punim akoma të pabotuar «Periudha me fjali të varur përcaktore në shqipen e sotme». Aty është trajtuar edhe **tipi përcaktor me nuanca rrjedhimore** (f. 180 vv. të punimit të daktilografuar).

ndajfoljes së mënyrës *kështu* me kuptimin e një rezultati dhe me bashkimin e lidhëzës ffillonjëse *që* (krahaso lidhëzën *sicché* të italishtes); lidhëza e përbërë në mënyrë *që* e cila mund të përmbajë jo vetëm kuptimin e rrjedhimit, por edhe nuancën e mënyrës (kur kallëzuesi i fjalisë së varur është në dëftore), nuanca e mënyrës shprehet me vetë emërin *që* ka hyrë në përbërjen e saj. Në ndonjë rast kuptimi i mënyrës është zbehur së tepërmi, për t'u zhdukur krejt, sidomos kur fjalia kryesore ka një gjymtyrë që funksionon si plotës mënyre. Kjo lidhëzë e përbërë është sajuar në kohët e fundit nëpërmjet të humbjes së mëvehtësisë sintaksore të emërit *mënyrë* në rasën kallëzore të pashquar (pa nyjë) me parafjalën *në* dhe të ish-përemërit lidhor *që*; kjo fjalë, e dalë nga një konstrukt relativ, sot ka kaluar plotësisht në kategorinë e lidhëzave, dhe përdoret në stilin publicistik-shkencor. Por kur kallëzuesi i fjalisë së varur është në lidhore, fjalia e varur ka kuptimin e qëllimit, dhe në periudhë tregohet se qëllimi synohet nëpërmjet një mënyre të caktuar të shtjellimit të veprimit të fjalisë kryesore.

Përemëri lidhor *që* bashkon fjalën e varur përcaktore me një emër të kryesores, dhe mbi kuptimin e përcaktimit shtohet nuanca rrjedhimore.

Lidhëzat (e thjeshta dhe të përbëra) në kombinim me korelatët e ndryshëm dhe elemente të tjerë të strukturës së periudhës, si mënyra e foljes, krijojnë tipe e nëntipe semantiko-strukturore me vetija mjaft të theksuara.

Le të shohim pra vetitë semantiko-strukturore të tipit të parë rrjedhimor.

2. TIPI KORELATIV LIDHËZOR-PËREMËROR

Emërtimi i këtij tipi vjen nga korelacioni i lidhëzës *sa* me përemrat [a ndajfoljet përemërore *aq(ë)*, *kaq(ë)*]. Mjetit të lidhjes, lidhëzës *sa* i përgjigjen në fjalinë kryesore fjalët korelative *aq(ë)*, *kaq(ë)* (në të folmet arkaike *aqë*, *kaqë* si dhe në gjuhën e shkruar gjer në dhjetëvjeçaret e parë të shekullit XX, ndërsa në vjetet e fundit vetëm *aq*, *kaq*, pa kurrfarë ndryshimi kuptimor). Korelatet *aq*, *kaq* janë në fjalinë kryesore fjalë dëftore me funksion lajmues, gjë që i bën mjet suplementar të mjetit të lidhjes (lidhëzës); prandaj lidhuria gramatikore dhe kuptimore midis fjalive është shumë e ngushtë: pa fjalinë e varur, fjalët *aq*, *kaq* do të kishin kuptim anaforik, përmendës dhe do të na dërgonin te konteksti i mëparëshëm. Këto korelatë dëftejnë sasi të madhe, jokonkrete, e cila mer një farë konkretizimi në veprimin, gjendjen a fenomenin e shprehur në të varurën rrjedhimore.

Sasia e shprehur nga korelati mund të ketë të bëjë me anë të ndryshme të fenomeneve:

- 1) me cilësinë e shprehur drejtpërdrejt nga mbiemri në bërthamën përemërore mbiemërore të tipit *aq i madh*, *aq radikal*;
- 2) me një «rrethanë» të shprehur nga një ndajfolje, në bërthamën përemërore ndajfoljore të tipit *aq i mirë*, *aq shumë*.
- 3) me sende konkrete ose abstrakte të shprehur me emëra substantivë në bërthamat përemërore emërore *aq njerëz*, *aq trimëri*

Korelati *i tillë, e tillë* (variante *i atillë, etj.*) si përemër dëftor i cilësisë bashkëlidhet me lidhëzën *që*, me lidhëzën *sa*, ose me përemrin lidhor *që*. Cilësia e shprehur nga përemëri ka lidhje me sendin dhe bëhet shkak për rrjedhimin e shprehur në fjalinë e varur.

Ka dhe ndonjë korelat tjetër që bën pjesë në «bërthamat frazeologjike. (shih më poshtë § 2.5).

2.1. Nëntipi përemëror-mbiemëror

Bërthama përemërore-mbiemërore përmban një togfjalësh mbiemëror ndajfoljor (me shtyllë gramatikore mbiemrin të përcaktuar nga ndajfolja); mbiemëri lidhet me një emër (ose me çdo fjalë të përdorur substantivisht) dymënyrësh:

a) kallëzuesorisht (kur mbiemëri është kallëzuesor¹¹) i fjalisë kryesore),

dhe

b) atributivisht (kur mbiemëri funksionon si përcaktor, si cilësor i emrit.

Shëmbull për rastin (a) : *Zëmërimi* i Sulltanit kundër Shqipëtarëve dhe Venecianëve *ishte aqe i madh*, sa në mes të dimrit një turmë prej 15.000 Turqsh, përmes maleve të mbuluara me dëborë u duk përpara Shkodrës. / NOLI: HeS³ (114) /

Shëmbull për rastin (b) : Në mes të këtyre femrave të liga kish *ca të reja kaqe të bukura* sa të mbeteshin sytë tek ato

V. KOKONA : Me valët e jetës (I)
(193)

2.1.1. Ndonëse për shprehjen e marrëdhënieve shkak-rrjedhim (shkak-pasojë) nuk ka rëndësi fakti në bëhet përcaktimi i emërit kallëzuesorisht apo atributivisht, prapsepapë, për strukturën e fjalisë kryesore kjo ka rëndësi, sepse ka të bëjë me vëndin e bërthamës përemërore në fjalinë kryesore. Dhe këtu mund të paraqiten tri raste në lidhjen kallëzuesore, sipas faktit që cilësia e shprehur prej mbiemërit i atribuohet emërit:

a) nëpërmjet të foljes këpujë «jam»;

b) nëpërmjet foljeve-këpujë të tjera, moskalimtare ose kalimtare pësore;

c) nëpërmjet të foljeve këpujë kuptimplote kalimtare vepërore.

2.1.1.a. Grupi më i madh i periudhave me fjali të varur rrjedhimore përbëhet nga ato që kanë në fjalinë kryesore një bërthamë përemërore me foljen këpujë «jam». Nga pikëpamja semantike, mbiemërat mund të tregojnë cilësi a veçori të çdo lloji; ndër ta më të përdorur janë mbiemërat që tregojnë një cilësi më të përgjithëshme si *i mirë, i madh, i bukur*, etj.; nga pikëpamja e fjalëformimit mbiemërat tregojnë mbiemërat të thjeshtë por nuk mungojnë edhe mbiemëra relativë, mbiemra prejfoljorë, mbiemëra kompozita si edhe emëra të përdorur adjektivisht me kuptim cilësie.

11) kallëzuesor, kallëzuesori, emër, term me të cilin tregojmë atë fjalë me varësi të dyfishtë sintaksore që varet njëkohësisht nga një emër a përemër dhe nga një folje që mund të jetë e xhveshur ose jo nga kuptimi leksikor (cf. le prédicatif.)

— (*Mishi i derrit*) *Është kaq i mirë sa që edhe thonjtë i lëpin* /KALLAMATA : Netë gjahtarësh (101)/.

(*Era*) *ishte aq e fortë, sa përmbysi dhe theu qelqin e llambës që ish varur në mur.* /A. MARA: Shtëpi e xha Milit (9)/.

Era ishte aq e lehtë sa nuk arriti të luante as qimen e flokut. GJATA: Armiqtë, in Nëndori, N 3, 1963 (19) /

Analiza qe kaq e imtë sa zgjati plot 8 orë.

/KALLAMATA : Gjëmbat e trëndafilit (44) /

Pylli ish aqë i qetë atë ditë, sa që asnjë fletë nuk lëviste /.../ KACORI : Për mëmëdhenë (I) (68) /

Fytyra e tij ishte kaq e çqetësuar atë dite sa që me një herë e pyeta se ç'kishte. /KALLAMATA : Gjëmbat e trëndafilit (65) /

/Skënderbeu/ *Ishte aqë kryelartë për këtë llagap turk sa e shtonte vetë gjithënjë pas emrit të familjes.* /NOLI : HeS¹ /

Po /Shekspiri/ është aq artist sa asgjëkunt nukë na lë përshypjen që na mban një konferencë historike dhe politike, të kurorëzuar prej një sermoni plot me mësimë morale. /NOLI : Makbeth, Introdiktë (6) /

2.1.1.b. Cilësia mund t'i lidhet emërit nëpërmjet të një folje këpujë që ka ruajtur vetëm pjesërisht kuptimin e vet leksikor:

/.../ *U tregua aq i zoti*

sa la emërë për jetë. /NAIM FRASHËRI, HeS /

/.../ me kohë, *Çapi i Ymerit u bë kaq i dëgjuar sa të zot filluan t'i thërresin Ymeri i Çapit* //KALLAMATA : Nete gjahtarësh (49) /

2.1.1.c. Mbiemëri (dhe rrallë një ndajfolje cilësore) i cakton një cilësi një emëri-kundrinë e drejtë nëpërmjet të një foljeje kalimtare vepërore. Varësia e dyfishtë e mbiemërit nga emëri kundrinë e drejtë dhe njëkohësisht edhe nga folja kallëzues mund të shprehet me trajtën e posaçme të kallëzores njëjës të mbiemërit cilësonjës të nyjeshëm (me nyjën të dhe jo e, kur mbiemri është i nyjeshëm), si dhe me mjete rithmo-melodike (pauza midis emërit dhe mbiemërit, nëqoftëse ndodhen pranë), si dhe me rendin e lirëshëm të vendosjes së mbiemërit kallëzuesor.

Zuri dhe të fliste. *Po ua bëri aqë të madhe ngjarjen, sa që të gjithë mbetën të lebetitur.* /KACORI : Për mëmëdhenë (I) (225) /.

Ne me Stojani *i kishim aqë pranë /gjermanët/ sa dëgjonim shkoqur bisedat e tyre.* /ANDONI : Tregime nga Morava (49) /

Flisnim ngadale dhe *fytyrat i kishim aqë pranë sa shihnja veten time në beben e syve të xha Dilkos.* /ANDONI : Maleve në Shënëndre (47) /

2.1.2. Mbiemëri mund t'ia caktojë cilësinë emërit edhe drejtpërdrejt, artibutivisht, dhe në këtë rast fjalët e togut përemëror kanë rend të caktuar: Emër+ndajfolje përemërore+mbiemër. Ky rend është i ngurosur, dhe shkaktohet nga rendi i rëndomtë i mbiemërave cilësonjës në fjali, me këtë ndryshim që në bërthamën përemërore nuk ndodh rasti i prepozicionit emfatik të mbiemërit, si në një fjali të pavarur çfarëdo; për këtë, duket, luan rol prania e përemërit-ndajfolje aq, (kaq) gjithëmonë në prepozicion. Nga ana tjetër, nuk ka as mundësi për të nxjerrë, fjala vjen, në krye të fjalisë kryesore togfjalëshin mbiemëror ndajfoljor, siç ndodh te tipet e tjera ku mbiemri është lidhur kallëzuesorisht me emërin.

Tre ushtarë të gardës rrëfuyen një trimëri aqë të madhe, sa

nderuan prej gjithë ushtrisë dhe prej popullit si pjesëtarë të lavdisë për këtë viktore në një radhë me kumandarët dhe oficerët. /NOLI : HeS² /

Ishte një qetësi *aqë e madhe* sa të fuste trishtim në shpirt. /GJATA : Armiqtë, Nëndori 1964 Nr.1 (47) /

Qysh në fëmijni Bukurusha kishte ndie një të ngrehun zemre *aq të fortë*, sa nuk dinte ma me da Gjonin e Lekën dhe të dy i përfshinte me një masë dashtnie, /...: (NIKAJ : Shkodra e rrethime (220) /

Po të krahasojmë rendin e përbërësve të bërthamës përemërore në rastet e lidhjes së mbiemërit atributivisht, nga njëra anë, dhe kallëzuesorisht, nga ana tjetër, del e qartë mundësia e lëvizjes përbrenda fjalisë të grupit togfjalësh mbiemëror të rasti i lidhjes kallëzuesore, si në shëmbujt e mëposhtme:

Aqë të kapitur ishin ushtarët nga kjo betejë qenërisht sa qëndruan dy ditë në fushë të Torviollit që të mbidhnin veten /NOLI : HeS² (39) /

(Këtu zagarët janë si në kuvlinë e tyre, anëtarë të klubit me të drejta të plota). *Kaq është e vërtetë*, sa dhe mezetë jepen me shumë kocka. /KALLAMATA : Netë gjahtarësh (37) /

Lidhur me ndajfoljen përemërore *aqë (kaqë)* përbrenda bërthamës përemërore, duhet të theksojmë se ajo vihet gjithëmonë përpara mbiemërit, sepse atij i referohet; në rast se bërthama përemërore zgjerohet me një emër, prania e ndajfoljeve përemërore *aq, kaq* përpara njërit prej tyre tregon se sasia e madhe e ka të bëjë me cilësinë e shprehur me mbiemrin (kur ndodhet përpara mbiemërit) dhe me sendin a sendet e shprehur nga emëri (kur ndodhet para emërit).

Natyra i kish falur atdheut tonë *vise kaqë të bukura* sa mund t'i kishte zili çfarëdo shtet në botë. /KOKONA : Me valët e jetës (I) (112) /

Prania e fjalës *kaqë* përpara mbiemërit të bukura tregon sasinë e madhe të cilësisë së shprehur nga mbiemëri ndërsa fjala *vise* ka kuptimin e thjeshtë sasiore që i jep trajta e shumësit.

Ndryshe qëndron puna në shembullin e mëposhtme:

— ...Më prittë me *aqë dashuri* e gëzim, më sualltë *aqë shërbime të çmuara e pa numër*, sa më bëtë më tepër ju robin tuaj se sa unë të lirë ju ... /NOLI : HeS¹ /

Në këtë shembull, emri *shërbime* përcaktohet nga fjalët të *çmuara* dhe *pa numër*; venia e ndajfoljes përemërore *aqë* përpara emërit *shërbime* tregon numurin e madh të tyre, ndërsa shkalla e cilësisë shprehet nga trajta pohore e mbiemërit të *çmuara* me të cilin është bashkërenditur togu *pa numër*; venia e ndajfoljes përemërore *aqë* përpara emërit që përcakton bën të tepërt përcaktimin e lartë sasiore që i bëhet po këtij emri leksikorisht me anën e kuptimit të togut *pa numër*, kështu që këtu, siç e ka paraqitur autori, kemi një përcaktim të tepërt. Mendojmë se autori, i tërhequr nga vendi i fjalës *aqë* pak më sipër (me *aqë dashuri*), ka vendosur në mënyrë mekanike fjalën *aqë* përpara emërit *shërbime*; qëllimi i tij ka qënë të shprehë jo sasinë e madhe të shërbimeve të çmuara (sepse këtë e ka bërë me mjete leksikore (= *pa numër*), por sasinë e madhe të cilësisë të *çmuara* dhe *pa numër* të emërit *shërbime*, sasi që ka sjellë pasojen

e shprehur në fjalinë e varur (a të varura). Në botimin e dytë, autori e ka korrigjuar me të drejtë si vijon:

... Më prittë me aqë dashuri e gëzim, me sualltë *shërbime aqë të çmuara dhe pa numër*, sa më bëtë më tepër ju robin tuaj, se sa unë të lirë ju. /NOLI : HeS² (29) /

Nga ana tjetër vendosja e ndajfoljes përemërore *aqë (kaqë)* prapa mbiemërit, paraqitet, e krahasuar me rastet e tjera të rëndomta, si një shkelje e normave ekzistonjese.

Udha e madhe do të jetë e *gjanë aq*, sa mund të kalojë kali me barrë e qet me zgjedhë. /GJEÇOV, KILD, DCXIII, § 268 /.

Do të jetë, pa tjetër, rendi *kaq* i pazakontë i fjalës *aq*, i që ka dhënë lidhëzën e përbërë *aqë sa* (shih më tej § 3.1.).

Në bërthamën përemërore mund të bëjnë pjesë më shumë se dy fjalë cilësonjese; përpara secilës ndajfolja përemërore *aq(ë)*, *kaq(ë)* mund të përsëritet (për arsye theksimi) në renditje asindetike, por zakonisht përdoren jo më shumë se dy mbiemëra dhe ndajfolja përemërore vihet vetëm përpara të parit, kur i dyti është bashkuar sindetisht.

Sulmi ishte aqë i ashpër dhe i drejtpërdrejtë sa ai e humbi torruan. /GJATA : Armiqtë, «Nëndori» 1964, Nr. 1 (28) /

2.1.2.1. Si variant i zgjeruar i bërthamës përemërore mund të paraqitet edhe togu me këta përbërës: përemër (= ndajfolje) *aqë (kaqë)* + ndajfolje e sasisë *shumë* + mbiemër cilësor». Përdorimi i këtij togu përemëror është i përhapur në gjuhën e folur popullore dhe ka gjetur pasqyrimin e vet edhe në gjuhën e shkruar.

Aqë shumë i shëndoshë ishte

Sa njëqind burra ta zinin

ajy brengë bukë kishte,

se poshtë dot nuk' e vinin. /NAIM Fr. HeS, III, 93 /

Dy ditë me radhë shkoi avukat më avukat, po të gjithë ishin *aqë shumë të zënë* sa nuk pranuan ta ndihmonin. /GJATA : Përmbysja /.

Tashti ata kishin mbështetur kryet mbi çantat e rënda, pinin duhan dhe ishin *aqë shumë të mallëngjyer*, sa mezi këmbenin nga një fjalë. /GJATA : Armiqtë, in Nëndori. 1964 Nr. 2 (66) /.

Në vënd të fjalës *shumë* mund të përdoret edhe ndajfolja e sasisë *pak*, por jashtëzakonisht rrallë.

Ishte *aqë pak i stërvitur* sa mezi bënte dy hapa.

Në këto raste, ndajfolja e sasisë *shumë*, *pak*, përdoret për të theksuar përkitazi sasinë e shumë ose të pakë të cilësisë drejtpërdrejt, me mjete leksikore, që në fjalinë kryesore, pavarësisht nga puna që bën tërthorazi fjalia e varur me anën e rrjedhimit.

Nuk mungojnë dhe rastet kur në vënd të një ndajfoljeje sasi të përdoret një ndajfolje cilësie si *marrisht*, *tmerrësisht*, të cilat shprehin në mënyrë figurative një sasi të madhe.

Dielli asht *aq marrisht i nxehtë* dhe aq egër të lëmon, sa që të rrahin tamthat si të rrahurat e farkatarit mbi hekurin e kuqun. /MIGJENI : Në kishë /.

Një përdorim i tillë nuk është karakteristik për të folurit popullor, ai është pronë e gjuhës së shkruar, natyrisht jo pa ndonjë ndikim nga gjuhët e tjera (frëngjisht, italisht, rusisht, etj.).

2. 2. Nëntipi përemëror-ndajfoljor

Bërthama përemërore mund të ketë në përbërjen e vet një ndajfolje mënyre ose një ndajfolje sasië: kjo është bërthama përemërore ndajfoljore, e përbërë nga togfjalëshi ndajfoljor - ndajfoljor.

2.2.1. Bërthama përemërore mund të përfshijë përveç ndajfoljes përemërore *aqë*, *kaqë* një ndajfolje që tregon cilësinë e veprimit të shprehur nga folja. Në fjalinë kryesore shprehet shkalla e madhe e cilësisë së veprimit në mënyrë të paçkoqur që konkretizohet nga pasoja e shprehur në fjalinë e varur.

Ndajfoljet e mënyrës më të përdorëshme janë *mirë* dhe *bukur*, që tregojnë në mënyrë mjaft të përgjithëshme cilësinë e veprimit.

E shtroj kaqe mir' Asinë

sa gjësendi s'pipërinte. / NAIM FR. HeS, III, 451.

Kordhën aq mir'e msojti,

sa kushdo, q'e shih, çuditej, NAIM Fr., po aty, III, 82.

Si rynë brenda në shtëpi, (...) ndezë një dritë, me qënë që dritaret *ishin mbyllururë kaqë mirë*, sa që përjashta kurrë s'muntnin të vështronin dritën. / GRAMENO: OXHAKU (13)/

I tregonte ngjarjet aqë bukur sa që njeriu e besonte.

/ SAKO : Bereqeti

Ai dinte të tregonte kaq bukur sa të gjithë qeshnin e shkuleshin nga gazi. / KOKONA : Me valët e jetës (55) /

Ahere brofi në këmbë, e ndjeu vehten të lehtë si veri dhe eci aqë shpejt sa muzgu e zuri brenda në qytet. / GJATA : Armiqtë, in

«Nëndori», 1964, N. 1 (23) /

Dhe java iku aq shpejt sa nuk u pa si iku / SHUTERIQI : Gurnecka (145) /

Ajeti vuri re se heshtja atë mëngjez ishte endur aqë hollë sa hapat e tij kumbonin si jehona të nënëdheshme. / GJATA : Armiqtë,

in «Nëndori» 1964 Nr. 1. (16).

Por në bërthamën përemërore mund të kemi edhe ndajfolje të tjera që tregojnë një vecori tjetër, jo domosdo cilësiore, të veprimit ose një rrethanë, si *afër*, *larg*, *lart*, *poshtë*, *ulët*, *thellë*, *lehtë*, *rëndë*, etj.

Ishin aq larg sa mezi mundte me ja dallue syni. / NIKAJ : Shkodra e rrethuese. Bukurusha (227) /

MURASHI : Nuk ka ra Leka *kaq poshtë*, /.../ sa ta gënjejë Tuç Maku në këtë mënyrë / JAKOVA : Toka jonë².

Disa nga këta aeroplanë *fluturonin aq ulët* sa dukeshin shënjat e Liktorit. / KOKONA : Me valët e jetës (I) (301) /

Dominoja *ka hyrë kaq thellë* në klubet e gjahtarëve, sa nuk mund të merret me mend një klub i tillë pa domino. / KALLAMATA : Netë gjahtarësh (57) /

Zbathur ajo *ecte aqë lehtë* sa që nuk i ndjente dhe vetë çapet e saja /.../ / KACORI : Për mëmëdhenë (I) (233) /

2.2.2. Veprimet të shprehur nga folja kallëzues mund t'i epet një tipar sasior me anën e ndajfoljeve të sasisë *shumë*, ndajfoljes së cilësisë dhe sasisë *fort* e dhe ndajfoljes së sasisë *tepër*. Në përdorimin e ndajfoljeve *shumë* dhe *fort* në disa raste vihet re një diferencim

fort i pakët semantik, aq sa ndonjëherë përdoren njëra në vend të tjetrës¹².

Më këto fjalë, ujërat u përzhjenë kaq shumë, sa shkumzuan nja njëzet çape më tej. /SHUTERIQI : Gurnecka (157) /

Kajmekami i ri i Kolonjës ishte trembur kaq shumë, sa nuk kishte guxuar të kalojë Qarrin. /KACORI : Për mëmëdhenë (I) (156) /

Këtu dëbora shtron kaq shumë, sa, në mëngjes, /.../ shkel në gjurmët e atyre që kanë çarë dëborën para meje. /KOKONA : Me valët e jetës, (I) (83) /

Aq shumë e tepëroi, sa mbeti fill i vetëm. /GJATA : Armiqtë, «Nëndori» 1964, Nr. 2 (5) /

Tashti shoqëria midis dy shokëve të vjetër ishte bërë edhe më e ngushtë e kaq shumë duheshin, sa velenakët i quanin vëllezër të një barku /. /DUSHI : UeV /

— Kaq shumë e do Evgjeninë, sa nuk jeton dot pa të? /GJATA : Armiqtë, «Nëndori» 1964, Nr. 3 (40) /

Ndajfolja fort përdoret rëndom pranë të tilla foljesh që mund të karakterizohen nga pikëpamje e intensitetit të shtjellimit të veprimit; pranë emërave korelativë nga fjalëformimi përdoret rëndom mbiemri i fortë. Ndër foljet më të përdorëshme mund të përmëndim të tilla si *shtrëngo*, *bërtas*, *kris*, etj.

Sytë iu mbyllën e iu shtrenguan aq fort sa i lëshuan xixa e desh ra /. /SHUTERIQI : Çlirimtarët (II) /

Nadireja ia ngjeshi kokën aq fort pas kumit, sa Teftës iu dërmua hunda e i lëshuan sytë xixa /Çlirimtarët (II) (VI, 5) /

I filloi hallot me zë të ulët dhe nga fundi po bërtiste kaq fort sa që mund të dëgjohesh përtej parkut në godinën tjetër.

/KALLAMATA : Gjëmbat e trëndafilin (85) /

/Hajdari / u shemb mbi krevatin që kërciti aq fort, sa bëri të gjëmojë bodrumi i gjithë. /SHUTERIQI : Çlirimtarët (I) (199) /

Ky m'i hoqi kaq fort veshët të nesërmen në shkollë, sa më dhembin edhe sot. /SHUTERIQI : Gurnecka (73) /

Unë e ndjeva atë çast kaq fort fajin tim, sa m'u përsëndye vehtja, /IDEM, Ibidem (87) /

Por në raste të tjera ndajfolja fort ka marrë kuptimin e ndajfoljes shumë, duke hyrë në korelacion semantik jo me mbiemrin i fortë i fuqishëm, por me mbiemrin i madh ose ndonjë mbiemër që tregon cilësi sasiore. P.sh.:

Kaq fort kishte krisë pushka nëpër udha të Shkodrës për tri ditë, sa fishekët e gjashtëreve dhe baroti nisën me u pakue (...). /NIKAJ : Bukurusha, in Shkodra e rrethet (27) /

Erë sqyfuri e randë i shtohet asaj vape e (...) djersa të mbulonte aq fort sa me të kullue për tokë /NIKAJ, ibidem (295) / (= mbuloj shumë, djersë e bollëshme).

12) Do t'ishte me interes studimi i paralelizmit semantik të mbiemërave dhe ndajfoljeve korelativë nga kuptimi ose nga fjalëformimi; si p.sh. i mirë — mirë; i fortë — fort, i madh — shumë; i shumtë — shumë; i paktë — pak, etj. Do të dilte në dritë përdorimi i mjeteve për të treguar në njerin rast vetije, cilësi, t'par të sendit (emërit), ose të veprimit (a foljes), në tjetrin.

U zëmërua kaq fort Kristaqi me mua, sa nuk më foli SHUTERIQI: Gurnecka (99) / (zëmërim i madh, veç në ka dashur autori të tregojë qëndrueshmërinë e zëmërimit, korelativ me *zëmërim i fortë*).

Përrjashta, dielli *shkëlqente aq fort* në qelqin e qiellit, sa të verboheshin sytë të shikoje nga dritarja. / SHUTERIQI: Kënga e pushka (14) /

(*dritë e fortë*, por *shkëlqim i madh apo i fortë*?)

Për rastin e ndajfoljes së sasisë *tepër* kemi vetëm dy shembuj; duket që përdorimi i saj është i kufizuar, sepse kuptimin e sasisë së tejmasës e tregojmë rëndom me anën e ndajfoljes *shumë*, kështu që në këtë sfond, kjo përbën një shkelje të normës, dhe duhet evituar.

Po apim dy shembujt të nxjerrë nga shkrimtari gjirokastrit V. Kokona.

Kjo vjershë e *kishte robëruar kaq tepër* Ismailin e mjerë sa që edhe në gjumë e shihte veten të shndërruar në shi të artë, që futej nga dritarja e mbyllur në dhomën e Pandhorës për t'u bashkuar me të për jetë. / KOKONA: Me valët e jetës (I) (77) /

Por shpirtrat *ishin tronditur aq tepër* sa edhe opiumi më i fortë s'kishte si t'i vinte në gjumë. / KOKONA: Me valët e jetës (I) (296) /

Në bërthamën përemërore mund të ndodhen më shumë se një ndajfolje, ashtu si mund të ndodheshin dy a më shumë mbiemra; ndajfolja përemërore përsëritet përpara çdo ndajfoljeje.

Aqë bukur dhe aqë rrjedhëshëm shkoi muhabeti sa inxhinjer Mborjes nuk i vajti mëndja asnjë grimëz se atë mbrëmje çdo gjë ishte e trilluar me shumë kujdes e marifet. / GJATA: Këneta (417) /

Pastaj të përgjigjej e ta shpjegonte çështjen *aq këthjelltë, aq bukur*, sa që s'kishte se si të mos ishte në një mëndje me të. / KOKONA: Me valët e jetës (I) (143) /

Bërthama përemërore mund të përcaktojë jo vetëm një folje por edhe një mbiemër foljor ose një pjesore, duke sajuar bashkë me të një konstrukt pjesor, një farë përcaktori të zgjeruar.

U ngrit edhe plaku zevzek *me buzët shtënguar aqë shumë* sa gati i çikej maja e mjekrës me majën e hundës së gjatë. / GJATA: Armiqtë, «Nëndori», 1964, N. 2 (34) /

Na qënqeshin nja dyzet *kuaj të ngarkuar aqë shumë* sa ment këputeshin në mes. / ANDONI: Maleve në Shënendre (98) /

2. 3. NËNTIPI PEREMËROR EMËROR

Ndajfolja përemërore *aqë, kaqë* (me funksionin e një mbiemri përemëror), mund të tregojë një sasi të madhe të një sendi a të një cilësie të sendëzuar të shprehur me emër. Me këtë rast tregohet se sasia e madhe e sendit a sendeve, ose sasia e madhe e cilësisë së emrit abstrakt sjell rrjedhimin e shprehur në fjalinë e varur.

Dallojmë dy raste:

1) emri tregon send konkret ose send abstrakt, por në këtë rast do të jetë kryefjalë a kundrinë e drejtë;

Kishte aqë para sa s'dinte ç't'u bënte.

2) Emri, rëndom abstrakt, bashkë me një parafjalë (*me*, ose *pa*) është plotës mënyre e fjalisë kryesore.

Bukurusha, në nusi, *ndriti* me bukuri të vetë *me kaq madhni, sa, nëpër Napol, për me çfaqë bukurinë e një femne, thohej — Bukurusha! Shkodranesha!* / NIKAJ : Bukurusha (305) /

Te rasti i parë tregohet se sasia e pacaktuar e sendit konkret të shprehur prej emrit konkretizohet tërthorazi nga rrjedhimi i shprehur në fjalinë e varur.

Shpeshët *bënë kaqë zhurmë* me krahët e tyre, sa e trembën inxhinjerin. / GJATA : Këneta (422) /

Sasia e shumtë e sendit abstrakt (e cilësisë së sendëzuar) sjell rrjedhimin e shprehur në të varurën.

Kish kaq të nxehtë sa që (), kur i vura dorën në ballë, ma përvëloi. / KALLAMATA : Netë gjahtarësh (86) /

Kësaj / kushkriptës, S. F. / *i jipte aqë rëndësi*; sa u vu në krye të komisionit, edhe doli vetë fshat më fshat për të shikuar njerëzit e për të bërë listat. / NOLI : HeS³ (35) /

/ Për të shëruar dembelët përdorëshin kura të ndryshme. Një nga këto ish edhe zbatimi i parimit të vjetër «kush nuk punon, nuk ha» që *bënte kaq efekt* sa që edhe dembelët e Stambollit pas një kure të tillë bëheshin levendë. / KALLAMATA : Netë gjahtarësh (25) /

Kur ndajfolja përemërore *aqë, kaqë*, përcakton një emër abstrakt me kuptim cilësie me parafjalën *me* dhe që shërben si plotësor mënyrë për fjalinë kryesore, nuk tregojmë më në mënyrë të pacaktuar sasinë e madhe të cilësisë së një emri, por sasinë e madhe të cilësisë së një procesi dhe emëri me parafjalën vepron ashtu si dhe ndajfoljet e cilësisë (të mënyrës).

Kalorësit u turrë kundër njëri tjetrit, po ushtat e tyre u dërmuan mi shqytet e hekurta dhe kuajt e tyre *u përpoqnë me aqë hov* sa u përmbysnë me gjithë kalorësit përdhe / NOLI, HeS¹, III /

Era hyri në dhomë *me aqë eshëm*, sa e bëri vëndin duman / SHUTERIQI : Gurnecka (162) /

Dhe *hahet* / hoshmari, S. F.) *me kaq shijë*, sa të shkrin në gojë. / SHUTERIQI : Gurnecka (29). /

Garda mbretërore, me Ajdinin në krye, (...), u sul e tëra si një trup dhe e goditi qëndrën turke me aqë tërbim sa kjo nisi të tronditet. / NOLI : HeS¹ /

Ai drejtoi trupin *me aqë nervozitet*, sa i shkau guna prej shpatullash. / SHUTERIQI : Çlirimtarët /

Në këto raste vendi i ndajfoljes përemërore *aqë, kaqë* është midis parafjalës *me* dhe emërit abstrakt (ose konkret); kjo është normë e përgjithëshme. Megjithatë disa shkrimtarë e shkelin këtë normë. Kjo karakterizon sidomos Dh. Shuteriqin, elbasanasin, por e gjejmë edhe te devolliu S. Andoni.

Një natë prej netsh, zëri i fyellit u gremis nga mali *aq me tërbim* sa Tanës i pushoi zemra në gji dhe iu prenë gjymtyrët. / SHUTERIQI : Kënga e pushka (27) /

E vërviti burri *kaq me forcë* dhe *kaq lart gjarpërin*, sa ky ra mbi ca gurë e nuk u pa sa copsha u bë. / IDEM : Gurnecka (29) /

Reshqitja ish e papritur dhe /ai/ po ikte *aqe me shpejtësi* sa nuk mundi të marrë frymë. / ANDONI : Maleve në Shënendre (8) /

Te Donat Kurti, kjo punë mund të jetë e shkaktuar nga nxjerrja krye; s'na besohet të jetë e sintaksës popullore.

(...) *aq me shumicë* del uji, sa merr fushën e i ngin gjith. Prralla Kombëtare (I) (107)/.

2.4. Shkalla e cilësisë së mbiemërit a të ndajfoljes në vënd që të shprehet në mënyrë të pacaktuar nga korelatët *aqë, kaqë* mund të shprehet edhe me ndajfoljen e sasisë së mjaftueshme *mjaft*. Tipari i përmendur në fjalinë kryesore përbën një motiv, një arsye të mjaftueshme për të sjellë rezultatin, përfundimin e përmendur nga fjalia e varur.

Kur kallëzuesi i fjalisë kryesore është shprehur me një folje, fjala *mjaft* përcakton ndajfoljen që plotëson foljen. P.sh. : Lajma e ardhjes së Firuz Pashës i vajti me kohë Skënderbeut, po *jo mjaft shpejt* sa /Skënderbeu, S.F./ të mblidhte ushtëri tjetër veç asaj që kishte në dorë, (...) /NOLI : HeS¹/.

Këtu fjala *jo* ka kuptimin e kallëzuesit mohor *nuk vajti* që plotësohet nga ndajfolja *shpejt*, të cilën e përcakton korelati *mjaft*. Kuptimi i konstruktit është se cilësia e veprimit nuk ishte e mjaftueshme për të sjellë rezultatin e përmendur në fjalinë rrjedhimore.

Kur kallëzuesi është emëror, ndajfolja *mjaft* përcakton kallëzuesorin e shprehur me mbiemër P.sh.:

Më 1411 /Gjon Kastrioti, S. F. / ishte *mjaft i fortë* sa t'i blatonte Venetisë 2,300 kalorës për një pension prej 1.000 dukatash në vit. /NOLI : HeS² (14) /

Po /Skënderbeu, S. F. /ish *mjaft i zgjuar* sa të mos binte në grackë (...). /NOLI : HeS¹ /

Në kësi konstruktësh, siç shihet, Noli përdor rëndom lidhëzën *sa*, ndërsa shkrimtarët më të rinj përdorin lidhëzën *që*. P.sh. :

Ky *qe një argument mjaft serioz që* kryeredaktori të mos pësonte gjë për vete, (...). /MUSARAJ : Para Agimit, «Nëndori» 1963 N 10(5) /

Por edhe ndajfolja *mjaft* mund të funksionojë si kallëzuesor:

Kjo *qe mjaft që* edhe ai të dënohej me disa vjet burgim. /MUSARAJ : Ibidem (34) /

Këto konstrukte nuk janë të gjuhës popullore; ato janë pronë e gjuhës letrare, ku janë përhapur nënë influencën e gjuhëve të mëdha evropiane.

2.4.1. Por «të mjaftuarit» mund të shprehet edhe me vetë foljen «*mjaftoj*» në trajtë të vetës së tretë.

Folja mund të përdoret në të dy numurat (vetë e 3-të) kur kryefjala ndodhet në fjalinë kryesore dhe është përkitazi në njëjës ose në shumës; si rrjedhim nuk është nevoja që periudha të ketë domosdo më shumë se dy fjali. P.sh. :

Ai /grushti, S. F. /qe i lehtë, si pendë, po megjithatë *mjaftoi* vetëm një e goditur e tij, që Ajeti të bjerë përdhe duke thirrur nga dhëmbja. /GJATA : Armiqtë, «Nëndori», 1964 N 1 (82) /.

Vetëm këto lëvizje e mendime shprehu me vehte e bija e Tod Lekës. Po *mjaftuan këto që* ndjenjat e saja të merreshin vesh nga të tjerët. /GJATA : Tana¹ /

Kur fjalisë kryesore i mungon kryefjala dhe punën e saj e bën përafërisht një fjali e varur kryefjalore, periudha duhet të ketë së paku tri fjali: një kryesore, një kryefjalore dhe një rrjedhimore. P.sh. :

Ai i kishte mërzitur shokët me tregimet e veta, dhe *mjaftonte të hapte gojën që të largoheshin të gjithë*.

Në këtë rast tregohet se është e mjaftueshme ngjarja e treguar nga fjalia e varur kryefjalore që të ndodhë ajo që shprehet nga fjalia rrjedhimore. Fjalia kryesore shpreh edhe një nuancë kushti.

2.4.2. Si një farë korelati i lidhëzës që ndonjëherë mund të përdoret edhe ndajfolja e sasisë *shumë*. E bashkuar me një mbiemër, ndajfolja *shumë* tregon se sasia, masa e cilësisë së shprehur nga mbiemëri është shumë e madhe dhe rrjedhimi pengohet (kur kallëzuesi i fjalisë kryesore është mohor), ose nuk mund të ndalohej (kur kallëzuesi i fjalisë së varur është mohor). Tipar karakteristik i periudhës është trajta e lidhës së foljes kallëzues së fjalisë së varur. P.sh. : /Edhe ashtu e varrë me tërsirë vëllan e vogël, edhe i pren tërsirën edhe e lan mbërnda në pus edhe iknë/; po pusi *nuk ish shumë i thellë* me uj, që të mbitej djali, po kish njera në griqë. /H. PEDERSEN : Albanesische texte mit glossar /.

Ngjarja ishte *shumë tronditëse* që të mos ngjallte një pështjellim të papërshtueshëm.

Kallëzuesit mund të jenë që të dy pohorë.

Rasti që *shumë i përshtatëshëm* që Emira me Qemalin t'ia deklaroi, të paktën zotit Ajet, qëllimin e tyre /MUSARAJ : Para Agimit, «Nëndori», N 10, 1963 (32) /.

2.4.3. Karakteristikë sasiore mund t'i epet mbiemërit edhe me ndajfoljen *tepër*, që korelon domosdo me lidhëzën që. Ashtu si edhe te konstruktet me koralatet *mjaft*, *shumë*, edhe në rastin e korelatit *tepër* kallëzuesi i së varurës përdoret në mënyrën lidhore dhe është tipar inherent i konstruktit.

Fjalia kryesore është pohore, dhe kur fjalia e varur është edhe ajo pohore, tregohet se cilësia është më se e mjaftueshme, është tej masës, më shumë nga ç'duhet, prandaj nuk mund të ndodhë ajo që thuhet në fjalinë e varur.

I biri (i Skënderbeut, S. F.), Gjon Kastrioti, ishte *tepër i vogël* që të vihej në krye të Ligës... /NOLI : HeS² (108) /.

Plaku ishte *tepër i vuar* që të bënte gabime të tilla.

Në qoftë se fjalia e varur është mohore (kallëzuesi me pjesëzën *mos*), atëherë periudha tregon se sasia më se e mjaftueshme, e tejmasës do të sjellë domosdo pasojën e shprehur në të varurën, me fjalë të tjera, në fjalinë e varur tregohet pashmangëshmia e rrjedhimit.

Çështja ishte *tepër e ngatërruar* që të mos kërkonte një shqyrtim të imtë e të kujdesëshëm.

Fshatari ishte *tepër naiv* që të mos mashtrohej nga matrapazët.

Konstruktet me korelatet *mjaft*, *tepër* i përkasin më fort gjuhës së shkruar, letrare, dhe në të folur mund të reflektojnë atë gjuhë, jo pa ndonjë influencë nga gjuhët e huaja, sidomos neolatine si frëngjishtja e italishtja. Mjafton të shikojmë strukturën në të dy gjuhët për t'u bindur, Cf. fr. : assez

trop	{	+ Adj. + pour +	{	Inf. que + Subj;
it. abbastanza troppo	{	+ Agg. + per +	{	Infinito

Këtyre konstruktëve u përgjigjet konstruktin me paskajore i gegërishtes, si te shembulli: — Ti je *tepër*, e re dhe e pashme për *mos me ngjallë* lakmitë e tërbueme të atyne anadollakëve. /NIKAJ : Shkodra e rrethimeve /.

2.5 NENTIPI PËREMËROR FRAZEOLGJIK

Aluzioni për shkallën e lartë të shtjellimit të veprimit të fjalisë kryesore mund të tregohet edhe me mjete të tjera, përveç përemrit-ndajfolje dëftore *aqë*, (*kaqë*). Të tilla janë togjet *gjer atje* (*deri atje*), *gjer n'atë gradë*, *gjer n'atë shkallë*, si dhe *më atë ditë*, *më këtë ditë*, etj.

Një pjesë prej tyre masën e shtjellimit të procesit e tregojnë nëpërmjet nocionesh hapësirore-vendore. Togjet *gjer atje*, *gjer n'atë gradë*, *gjer n'atë shkallë*, kanë në përbërjen e vet parafjalën *gjer* (*deri*) e cila tregon shkallën ekstreme, skajin fundor të shtjellimit të veprimit. Vetë nocioni hapësiror-vendor shprehet ose me anën e ndajfoljes së vendit *atje*, ose me një emër që ka kuptim leksikor të shkallës a masës (*gradë*, *shkallë*); prania e një përcaktori korelativ (*atë*, *një*, *të tillë*, etj.) e bën të paplotë tregimin e vërtetë të shkallës, e cila shtjellohet në mënyrë të tërthortë nëpërmjet të rrjedhimit të shprehur në fjalinë e varur. Nga ana tjetër, togjet *më këtë ditë*, *më atë ditë* tregimin e shkallës e bëjnë nëpërmjet të një nocioni hapësiror-kohor, me praninë e emërit ditë, që tregon një fragment kohor, duke treguar në saje ndrrimesh semantike *gjendjen* (*e keqe*) të sendit a personit nëpërmjet të ditës, kohës kur ka ndodhur ajo gjendje.

Këta togje, që kanë përbërje të caktuar leksikore, të pandryshuarshme, si dhe elementë korelativë si përemërat dëftorë, janë shndruar në një farë bërthamë frazeologjike, e cila me tërësinë e saj shërben si korelat i fjalisë së varur në kryesoren. Këta mund të quhen pra dhe togje përemërore frazeologjike ose korelatë frazeologjike.

Shtirirja hapësirore-vendore mbështetet edhe te kuptimet leksikore të foljeve kallëzues së fjalisë kryesore: një pjesë e mirë prej tyre janë folje moskalimtare që tregojnë lëvizje (*arrij*, *vete*, *shkoj*, etj.). Më e përdorëshmja është pa tjetër folja *arrij* e cila edhe me kuptimin e vet leksikor tregon cakun fundor të shtjellimit të veprimit. Këto folje, veç, kanë humbur mjaft nga kuptimi leksikor i pammë, gjë që ka kontribuar për shndrrimin e tyre në togje frazeologjike.

Gjer atje kishte arrirë puna sa Turqit, me një ushtëri të vogël, kishin shpresë ta merrnin Krujën, përpara së cilës ishte prapsur me turp e tërë ushtëria turke nënë Sulltan Muratin II dhe nënë Sulltan Mehmedin II. /NOLI : HeS² (109) /

— Unë e di se ky pushtet ma ven kambën, o Lekë, por nuk e thotë Zoti *t'arrijë deri atje* sa të largojë edhe nga fëmijët e mi. /K. JAKOVA : Toka jonë² (41) /

Nganjëherë, bile, *arrinte gjer atje* sa të mallkonte veten (...) (N. PRIFTI : Çezma e floririt (79) /

Puna *vajti gjer atje* sa iu mblodhë gjyshit vërsnikët e tija dhe rrahnë ta sjellin mb'udhë. /ANDONI : Maleve në Shënëndre (19) /.

Si kallëzues të fjalisë kryesore mund të përdoren edhe folje kalimtare veprorë a pësore me kuptimin e përgjithëshëm leksikor të shndrimt të gjendjes. P.sh.:

Një komp, *i cili është mërztur gjer n'atë pikë* nga terrorizma e guvernës kombëtare sa të preferojë invazjen e huaj dhe ta quajë si të vetmin shpëtim, është i dënuar fatalisht ta humbasë independencën politike. /NOLI : Makbeth, Introdiktë (4) /

Po këtë /luftën bashibozuke, S. F. / e perfeksionoi gjer me një shkallë (të tillë, S.) sa me këtë armë primitive ishte i zoti të thyente dy nga Sulltanët më të mëdhenj të Turqisë me ushtëritë më të mira të asaj kohe. /NOLI: HeS² (116)

Kësi foljesh mund të plotësohen edhe nga togjet *më atë ditë, më këtë ditë*, ku fjala me kuptim fragmenti kohor *ditë* nëpërmjet ndërri-mesh semantike mjaft të theksuara ka arritur gjer atje sa të shprehë kuptimin e fjalës *gjendje* (pra, më këtë gjendje, m'atë gjendje) P_{sh}:

Po djajtë e djallëzitë
e çmëtnë së rish Mehmenë,
dh'e *prunë më atë ditë*.

q'u bë prap armik me Mbrenë! /NAIM FR.: HeS, XXI,
165 (321) /.

— Me ç'të drejtë *më ke bërë më këtë ditë* sa s'lëviz dot nga vëndi?
/GJATA: Armiqtë; «Nëndori». 1964, N^o1 (70) /.

Mjeti i lidhjes së fjalisë së varur me kryesoren mund të jetë lidhëza *sa*, si dhe lidhëza *që*. Lidhëza *sa* ka një përdorim më të gjerë, sidomos në gjuhën e shkruar, kurse lidhëza *që* është më tepër karakteristike për gjuhën e folur popullore si dhe për shkrimet që i qëndrojnë më afër asaj. Prandaj s'mund të pajtohem kurrsesi me vërejtjen që i bën prof. K. Cipo vargut të Naimit në fund të faqes 321» të botimit të Historisë së Skënderbeut redaktuar prej tij, (13)» q'u bë prap armik me Mbrenë, shqip do t'ish më mirë kështu: sa u bë prap armik me Mbrenë, se është fjali rrjedhore».

Theksojmë se me çdo lidhëzë fjalia e varur është gjithëmonë rrjedhimore (rrjedhore), dhe në të dy rastet fjalitë janë barabar shqip. Lidhëzat ndryshojnë vetëm nga sfera stilistiko-gjinore e përdorimit.

Përkundrazi, të dy shëmbëllat e mëposhtme të marra nga shkrimtari M. Grameno, fjalitë e varura bashkohen drejtpërdrejt me anën e trajtës së lidhore dhe nuk kanë korelat frazeologjik të shprehur (por të nënëkuptueshme lehtë). Mungesa e togut korelativ *gjer atje*, etj. si dhe mungesa e lidhëzës *sa* e erësojnë kuptimin e shkallës së shtjellimit hapësiror të veprimit dhe rrjedhimi nuk paraqitet mjaft i qartë.

Tani jam i çkujdesur për atë bushtrë të bukurë që më s'ka t'i prish-një mëndjen djalit t'im *i cili hariu* (sic) *të mos mentohet* i kujt bir është / GRAMENO: Oxhaku (8) /.

Andaj sot *kishte harirë* nga tmerri dhe nga frik'e Perëndisë *të ndryshonjë* edhe emërin me një të remë, (të ronjë lark të njojturve nëpër aratimet, /IDEM, Ibidem (44) /

Mungesa e korelatëve frazeologjikë dhe e lidhëzave përkatëse *sa* dhe *që* sot përbëjnë një shkelje të normës së përgjithëshme.

2.6 NENTIPI PËREMËROR I CILËSISË

Bërthama përemërore e fjalisë kryesore mund të ketë si korelat të lidhëzës përemrin dëftor *i tillë, e tillë*. Ky përemër dëftën pa e emërtuar një cilësi, dhe në periudhën me fjali të varur rrjedhimore

13) NAIM FRASHËRI, Historia e Skënderbeut, Tiranë, 1952.

paraqitet gjithmonë me funksionin lajmues. Esenca e kësaj cilësie të pashprehur konkretizohet tërthorazi në fjalinë e varur nga kuptimi i rrjedhimit.

Dallojmë dy raste:

1) korelati *i tillë* ka të bëjë me lidhëzën *që*,

2) korelati *i tillë* ka të bëjë me lidhëzën *sa*

Lidhëza *që* ffillëzon cilësinë reale të përemërit *i tillë* nëpërmjet të rrjedhimit, i cili ka nuancë cilësore. Kjo do të thotë se cilësia tek e cila referon përemri është cilësi e mirëfilltë.

Përemri *i tillë* (më rrallë, *i atillë*) mund të ketë në fjalinë kryesore funksionin e kallëzuesorit ose të cilësorit.

Përemri në funksionin e kallëzuesorit, lidhëza *që*:

(Po unë sillësha me atë mënyrë, se ashtu e deshte shpëtimi juaj dhe imi, se) puna ishte e atillë që duhej bërë dhe jo thënë, (...).
NOLI : HeS² (28) /

Heshtja *qe e tillë* që zhurmën e një qepeni e dëgjonte gjithë pazari. / SHUTERIQI : Çlirimtarët (II) (III,10) /

Heshtja *ishte e tillë*, që Tefta ndjeu mornica nëpër trup. / IDEM, ibidem (II) (IV,6)... /

Lajmi u shpërnda menjëherë në të gjithë botën dhe të nesërmen korrespondentë nga an'e anës sulmuan spitalin, por gjëndja ime shëndetësore e sidomos mendore *ish e tillë* që doktorët ndaluan vizitat. / KALLAMATA : Nete gjahtarësh (12-13) /

Në rast se duam të theksojmë kryefjalën, këpuja *jam* del në krye, pastaj vjen emëri dhe më pas përemri *i tillë*; fjala që shpreh kryefjalën merr një theks suplementar, kurse përemëri *i tillë* ka vetëm theksin e tij, dhe në këtë mënyrë fjalët që ndodhen pranë e pranë nuk formojnë dot një togfjalësh emëror-mbiemëror. Fjalitë ndahen me një pauzë të ndijëshme.

P.sh.

«Është situata e tillë që njerëzit humbasin kollaj torruan; MUSARAJ : Para Agimit; «Nëndori» 1963, N°11 (54) /

Dhe, pa tjetër, ai diç di më tepër nga ne të tjerët, po është natyra e tij e tillë, që nuk çfaqet. / IDEM, Ibidem, N°10(47) /

Përemëri *i tillë* me funksion mbiemëri mund të jetë i bashkërenditur edhe me mbiemra të tjerë cilësorë të fjalisë kryesore.

Reforma agrare në vendin tonë ka qënë e thellë dhe revolucionare, e tillë që mund të bëhet vetëm atëhere kur klasa punëtore të jetë në fuqi. / E. HOXHA : Kongresi i III i Frontit Demokratik /

Po kur përemëri dëftor *i tillë* referon te një vetijë cilësore e cila në bazë të lidhjes me kryefjalën përbën një cilësi sasiore, si p.sh. te mbiemërat cilësorë me kuptim semantik të nuancës së sasisë (i madh, i rëndë, i shpeshtë, etj.) në vënd të lidhëzës *që* mund të përdoret lidhëza *sa*. P.sh. :

Era e tyre (era e trëndafilave, S. M.) (...) *ish e tillë*, (...) *sa* gjith zozt e bletët (...) ajo erë i ndillte / ÇL SHUTERIQI : Çlirimtarët (II) /

Këtu përemëri dëftor *i tillë*, me qenë se na drejton te emëri *erë* dhe konkretizohet në rrjedhimin e shprehur në fjalinë e varur, do të referonte te mbiemëri cilësor *e fortë*, *e fuqishme*, i cili ngërthen me kuptimin semantik të cilësisë nuancën e sasisë. .. Kjo, më duket, është arësyeja e përdorimit të lidhëzës *sa* dhe jo *që* në fjalinë e varur.

Lidhëza sa (dhe zaten edhe sa që, ndonëse më rrallë) përdoret edhe kur përemëri *i tillë* ka funksionin e një cilësi. P. sh. :

Po, përsa u takonte shkrimeve të tjera, ato ishin një *këmbanë e tillë* alarmi kundër abuzimeve, rryshfeteve, papunësisë dhe mjerimit (...), *sa që* botimi i tyre mund të sillte pasoja të rënda. /MUSARAJ : Para Agimit, «Nëndori» 1963 Nr. 10 (10) /.

Fëmijët u sulën të rrëmbejnë paratë dhe u bë një duman dhe një *tym i tillë*, sa ati u tërbua (...). /SHUTERIQI : Kënga e pushka (84) /.

Ishte një *mori e tillë dallëndyshesh*, sa nuk kisha parë kurrë në ato pak vjet të jetës sime (...). /IDEM: Gurnecka (9) /

Të tilla nuanca shprehen edhe kur korelati *i tillë* cilëson një plotësor mënyre, ose është vetë pjesë përbërëse e një konstrukti që tregon mënyrë.

E ëma / e Skënderit, S.F. / e mori me gishta /pataten/, S. F./ e ia hodhi një macje të zezë me krahërorin të bardhë, maces së shtëpisë, e cila *e vështronte me një sy të tillë* djalin, që nuk mund të thoshe se çfarë shprehte, — zili apo admirim. /SHUTERIQI : Çlirimtarët (I) (1...) /.

Kur s'arrinte të kapte telin me duar, e zinte me dhëmbë dhe *e shtrengonte me një pasion të tillë*, sa të vinte mëndja se ishte duke shqyer armikun e tij më të tmerrshëm. /N. PRIFTI : Çezma e Floririt (123) /.

Natyrisht /Shekspiri/ e ndrroj dhe e shtoj dhe *e ujdisi me një mënyrë të tillë* sa nga pralla pa vlerë e Cinthios krijoj një kryevepër artistike nga më të mëdhatë në botë. /NOLI : Othello, Hyrje (6) /.

Kur përemëri korelat cilëson një plotës mënyre të shprehur me emër me parafjalën *me*, mjetei i lidhjes që përdoret më rëndom është lidhëza që. Këtu mund të shohim edhe një farë ndikimi nga konstruktet përkatëse të gjuhëve të tjera si frëngjishtes, rusishtes dhe italishtes (de telle manière que; in tal modo che; таким образом что так что).

Në votat e para (më 1922), ai *veproi në të tillë mënyrë që partitë* e ndryshme të qytetit (...) kujtuan, të dy palët, se kish votuar për ta. /SHUTERIQI: Çlirimtarët (I).

Foli *me një ton të tillë*, që të thoje se nuk donte vetëm të shpëronte dikë, po dhe të marrë hak kundër dikujt. /IDEM, Ibidem, (II) (III. 6) /.

Konstruktet me korelatin *i tillë* janë më së fortë të gjuhës letrare; këtu shihet një pasurim i mëtejshëm i shqipes së shkruar me modele të ngjajshme me ato të frëngjishtes, italishtes, anglishtes, gjermanishtes e rusishtes¹⁴

Kur korelati *i tillë* është kallëzuesor, fjalia e varur, duke mbushur këtë përemër me brendi reale konkrete, luan një rol sintaktik të ngjajshëm me atë të kallëzuesorit, por nga brendia reale, ajo tregon rrjedhim, dhe për ne, fjalia e varur është rrjedhimore; ndërkaq sipas ndarjes së dyfishtë logjiko--gramatikore, fjalia e varur do të merrej kallëzuesore-rjedhimore¹⁵ (kallëzuesore për arsye të strukturës, rrjedhimore për arsye të brendisë kuptimore. Kjo përbën një nga të metat e klasifikimit tradicional logjiko-gramatikor të periudhave me fjali të varur.

14) Krh. fr. tel «que; it. tale... che; angl. a such...; such...a; gjerm. solcher dass; rus. такой... что

15) Cf. S. Prifti: «Sintaksa e gjuhës shqipe Pj. II, Disp. II, Tiranë, 1962.

2.7. Tipi korelativ mungesor lidhëzor-përemëror

Lidhëzës *sa* mund të mos i përgjigjet në fjalinë kryesore ndonjë korelat sasior; në këtë rast, periudha me fjali të varur rrjedhimore karakterizohet nga këto tipare:

1) Korelati që mungon mund të shtihet në fjalinë kryesore pa shkaktuar ndryshime esenciale në marrëdhëniet e shprehura në periudhë;

2) Sasia e cilësisë, ose sasia e veprimit (shtjellimi në kohë e n'intensitet) arrin të shprehet tërthorazi nëpërmjet të rrjedhimit dhe jo nga prania e ndonjë fjale a togfjalëshi me kuptim të caktuar leksikor të sasisë konkrete (si p.sh. shumë krejt, etj.); lidhuria midis fjalëve është gjithëmonë e madhe, po aq e madhe sa në rastin e pranisë së korelatit. Në rast të kundërt, duke qënë se që në fjalinë kryesore është treguar me mjete leksikore një sasi e madhe konkrete, kjo fjali është e plotë jo vetëm nga pikëpamja gramatikore, por edhe nga pikëpamja leksikore, kështu që fjalia e varur nuk mund të marrë korelat dhe konstruktet e këtij tipi i përkasin tipeve lidhëzore jo-korelative (shih më poshtë paragrafin 3.1. e vv.)

Aty nga dreka, ndënë rrap bëhej një hije aq e gjerë sa mund të mërzejnë në të gjithë bagëtitë e imta të fshatit. /GJATA :Tana¹.

Lumenjtë inin të rrëmbyer sa nuk kapërxehehin dot. /KACORI : Për mëmëdhenë (I) (255) /

Në këta shembuj e të tjerë këso dore, korelatët *aq*, *kaq* mund të shtihen fare lehtë, pa sjellë ndonjë ndryshim në marrëdhëniet midis fjalisë; i vetmi ndryshim është se fjalia kryesore, që paraqitej disi e paplotë semantikisht në sajë të korelacionit të brendive të fjalive, por që gramatikisht kish strukturën e një fjalie relativisht të plotë, pasi u shti korelati në të, në sajë të kuptimit dëftor lajmues të ndajfoljeve përemërore *aq*, *kaq* u bë e paplotë edhe gramatikisht. Përkundrazi në shembullin e mëposhtëm fjalia kryesore s'ka nevojë për korelat dhe fjalia e varur është bashkuar me kryesoren me një lidhuri shumë të çlirtë; kësi konstruktesh u përkasin tipeve jokorelative.

(...) atje tek do të vinjën ishte një mal shumë i lartë, sa asnjë njeri nuk munte të hipte (...)/ DOZON : Manuel... (82) /.

Në tipet korelative mungesore një farë shkalle a intensiteti mund të shprehet që në fjalinë kryesore dymënyrash: 1) me mjete leksikore dhe 2) me mjete gramatikore.

Le të shqyrtojmë rastin e parë.

Kallëzuesi i fjalisë kryesore i papërcaktuar nga ndonjë ndajfolje sasië është shprehur me folje të tilla që nga kuptimi leksikor tregojnë një farë intensiteti; pra këtu në vetë semantikën e foljes kallëzues kemi të shprehur një farë intensiteti të shtjellimit të veprimit. Folja *gjëmon* («te «zëri gjëmon»); ulërin (te «njeriu ulërin»), *egërsohem* (me kuptimin «zemërohem në kulm»); *trëtem* (= dobësohem, ligem pa masë) kanë në kuptimin e tyre leksikor dhe një shkallë të madhe të intensitetit të shtjellimit të veprimit; në raste të tjera kemi folje të tilla të cilat, të shoqëruara nga emra me kuptim të caktuar

leksikor, tregojnë në mënyrë frazeologjike ose figurative ekspresive intensitet të veprimit, si p.sh. : *kërcet* (kënga, druri, kopaça), *i heq dikuj* (një shuplakë, një dackë, një shkelmë, një dru); *i këpus dikuj* (një të sharë, një dru, një kopaçe, një bisht lopate, një bisht cfurku), etj. P.sh. :

Pushka dhe topi kish dalë,
dhe zër'i tyre gjëmonte
sa trënditte gjithë malë,
po prapë shpata gjykonte /NAIM FRASHËRI : HeS /
Ng'ajy mall'i shumë u mpinë
sa të katrë u sëmure. /IDEM : HeS /

Ulëriti një herë sa u tund pylli, pastaj ra në tokë pa shpirt ./
KALLAMATA : Netë gjahtarësh (78) /

Ajo ulurin sa zgjon edhe kalamajtë nga gjumi.

Në shtëpinë e Luçit *krisi kënga* sa u tund fshati. /DUSHI : UeV /.

Dikur *ka krisur kopaça* në fshatin tim sa na mbetën gjerdhet pa hunj e pa purteka. /ANDONI /.

Gyshi u egërsua sa i dridheshin dejet e faqeve. /IDEM

(Ethet e shtrëngonin dita ditës më shumë). Pas tri javëve *u tret* sa mezi mbahej më këmbë. /SHUTERIQI : Çlirimtarët I.

Dhe *i hoqi një dackë serratit*, sa i lëshuan(...) sytë shkëndia.

(...) Trifoni, për të çfryrë prapë inatin, e ndoqi /derkucin /, nga pas e *i këputi një bisht cfurku* në kërbishtet sa kafshës nuk i ra ndër mend më për të vazhduar aksionin. /DUSHI : UeV /.

S'pati as turp cipëplasuri po e përfshiu Katzrinën në sy tim, e ngriti lart, e puthi dhe e *shtrëngo*j sa i krisnë koskat. /ANDONI :

Megjithkëtë, tregimi i një farë intensiteti të veprimit në fjalinë kryesore nu ke bën të plotë këtë fjali, sepse nëpërmjet të rrjedhimit i atribuohet *një shkallë e madhe* veprimit, kështu që në fjalinë kryesore mund të vendoset jo korelat sasiore, *aq*, *kaq* por një togfjalësh ndajfoljor (*aq shumë*, *aq fort*, etj.) ose ndonjë tjetër togfjalësh, me fjale të tjera një bërthamë e tërë përemërore.

Ky rast është mjaft i shpeshtë në gjuhën e folur popullore. P. sh.

Zolejka iu ngjit si ngjalë,

U zëmërua sa qau! /ÇAJUPI : Zolejka /.

Majen grat sa s'i xen kmisha. /KPLr. (57) /

— Po. *U mërzita* sa më ka ardhur në majë të hundës.

E dua, sa lotë më rrjedhin për të, (...).

Kafshoi gishtin sa e bëri gjak.

Mblodhi grushtet guraxhiu sa thonjtë i hynë në misht.

Luftoi xha Coli aty në brigjet e Vlorës, sa u çuditën të tjerët.

Në shëmbullin e parë mund të rivendosim pas foljes togfjalëshin ndajfoljor *kaq shumë* (u zëmërua *kaq shumë* sa ...), kurse në atë të fundit mund të rivendosim pas foljes «luftoi» togfjalëshin *me aq trimëri*, ose ndonjë variant tjetër (*luftoi me aq trimëri...sa...).*

Por në rast se korelatet *aq*, *kaq* do t'i vendosim për theksim përpara foljes kallëzues, këta mund të qëndrojnë edhe vetë pa ndonjë përcaktor të përshtatshëm ndajfoljor, kështu që nuk është e domosdoshme prania e gjithë bërthamës. Këtë mundësi ia jep topika para foljes dhe theksi i fuqishëm i shqiptimit, si te shembujt e mëposhtëm.

Kaq u gëzova sa s'di si t'jau tregoj. /SAKO : Bereqeti (85) /.

Spiunët n'Itali kaq më deshën sa më ndiqnin pas si manaret!...
(P. MARKO : Hasta la vista (290) /.

— Shqiptar! Fle?

Ky zë *kaq e trëmbi* (Gorin), sa *u* hodh përpjetë... (IDEM, Ibidem (139) /.

Kështu *kaqë (i) mësoi* ai shejtanllëket, sa hëngri edhe ata që e kishin mësuar. /DOZON : Manuel. (78) /.

2) Përsëritja e së njëjtës trajtë foljore të së njëjtës foljeje me bashkimin e tyre nëpërmjet lidhëzës bashkërenditëse këpujore e tregon shkallën e madhe të shtjellimit të veprimit, e cila bëhet shkas për rrjedhimin e shprehur në fjalinë e varur.

Kuptimi i sasisë së madhe a i intensitetit të madh të shtjellimit të veprimit është kaq i fortë te këta togje foljorë sa asnjë korelat ose bërthamë përemërore praktikisht nuk përdoret në fjalinë kryesore dhe nga kjo pikëpamje këto konstrakte qëndrojnë kaluar midis tipit korelativ mungesor dhe tipit jo korelativ.

/Teto Sofa / *Qau e qau*, sa ia bëri nuses qull futën. (SPASSE : Afërdita përsëri në fshat.

Dhe vasha *qau e qau* sa u tret (.) / N. PRIFTI, Çezma e Floririt (15) /.

Thirra e thirra sa s'mbaj mend se ç'thashë /

Piu e piu sa s'iu lagën as buzët /

Në shembullin e fundit, kallëzuesi është përdorur me qesëndi, me shaka, dhe falë kësaj mer kuptim mohor (nuk piu hiç),

Togjet foljore përbëjnë një kallëzues të vetëm.¹⁶

3. TIPI LIDHËZOR JOKORELATIV

Ky tip përfshin grupin e dytë të periudhave me fjali të varur rrjedhimore, që dallohen nga periudhat e grupit të parë nga një varg karakteristikash.

1. Lidhëzës së fjalisë së varur nuk i përgjigjet dhe s'mund t'i përgjigjet ndonjë korelat në fjalinë kryesore. Kjo shkakton një lidhuri më të dobët midis fjalive, që shprehet edhe në intonacionin e periudhës, në pauzën e domosdoshme midis fjalive.

2. Fjalia kryesore është relativisht më e plotë, ajo nuk përmban elementë dëftorë sasiore a cilësore të cilët të konkretizohen tërthorazi nga brendia e fjalisë së varur nëpërmjet rrjedhimit.

3. Brendia e fjalisë së varur përbën në më të shumtën e rasteve një thënie që epet si konkluzion logjik i brendisë së fjalisë kryesore. Në raste të tjera, sidomos kur fjalia e varur bashkohet me lidhëzën që jokorelative, periudha mund të përmbajë gërshetime nuancash mjaft

¹⁶ Krahaso te Mehmet Çeliku: «Disa togje foljore në shqipen e sotme», «Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Serija Shkencat Shoqërore», Viti 1963, Nr. 1, f. 174. Togjet foljore të trajtuara prej nesh dallohen prej atyre që trajton M. Çeliku sidomos për faktin se ata përdoren rëndom në të kryer të thjeshtë ose në të pakryer dhe veç kësaj ndodhen në periudhë me fjali të varur, ndërsa këta përdoren «në mënyrën urdhërore edhe dëftore; kur ato janë në mënyrën dëftore më tepër përdoren pa lidhëza ndërmjet» (f. 174).

të laryshme që shkaktohen nga lidhja reciproke e tipareve strukturorë dhe e brendive reale të fjalive të periudhës.

Klasifikimin e nëntipave të tipit lidhëzor jokorelativ po e parashtrojmë duke u mbështetur tek elementi kryesor i strukturës, lidhëzat, ndërsa elementet e tjera epen gjatë parashtrimit.

Kemi këta gjashtë nëntipe:

- 1) Nëntipi lidhëzor jokorelativ me lidhëzat *aq(ë) sa, kaq(ë) sa*
- 2) Nëntipi lidhëzor jokorelativ me lidhëzën *kështu që,*
- 3) Nëntipi lidhëzor jokorelativ me lidhëzën *në mënyrë që.*
- 4) Nëntipi lidhëzor jokorelativ me lidhëzën *gjersa*
- 5) Nëntipi lidhëzor jokorelativ me lidhëzën *që,*
- 6) Nëntipi lidhëzor jokorelativ me lidhëzën *që tek*

3.1. Tipi lidhëzor jokorelativ me lidhëzat *aq(ë) sa, kaq(ë) sa*

Korelatët *aq(ë), kaq(ë)*, të vetëm, duke u çvendosur prej pozicionit para foljes pas saj arritën të ndodhen menjëherë përpara lidhëzës *sa*. Ky pozicion në kohët e para u kish ruajtur korelatevet theksin e tyre të fuqishëm, duke ruajtur njëkohësisht të ndarë korelatet nga lidhëza. Mungesa e një karakterizimi sasior konkret të mbiemërit ose foljes në fjalinë kryesore i mbante akoma korelatet përbrenda strukturës së kësaj fjalie. P. sh.

Qysh gjuha shqip s'është prishur'e ndryshuarë duk me mos pasurë shkronja e libra e duk me mos shkruar'e kënuarë nëpër shkolla, kur gjuhëra të shkruara e të ndërhuara me kujdes të madh janë prishur' e ndryshuarë aqë sa të quhenë gjuhëra të tjera? /SAMI FRASHËRI : Shqipëria⁷ ... (29) /.

Udha e madhe do të jetë e gjanë aq, sa mund të kalojë kali me barrë e qet me zgjedhë /GJECOV : KILD, DCXIII, 268 /¹⁷

Mbas një copë here e fillon një dhimbje kreje e fortë aq, sa i dukej se tamthat dojshin me i plas / .NIKAJ : Shkodra e rrethueme (234)¹⁷

Këjo (vajza S. F.) pas fjalës mbretit e vë (morrin, S.F.) sefteden në një kuti, po pas pak (morri) na u rrit *kaqë sa* nuk e nxurri dot kutia. /DOZON : Manuel. . . (28) /.

/Një baba na dërgoi të birin në shejtanë që të mësonjë shejtanllëket/ Në krye të një moti *u mësua* kyj (djali, S. F.), *kaqë sa* i shkante shejtanët. /IDEM, Ibidem, (75) /.

Djali vehet me kujdes me i ba punët e shpis, tuj shi e tuj dliërë, kështu qi *u hin në hatër* (djemenvet, S.F.) *aq, sa nisin* me e ia lanë në dorë çilcat e odave / D. KURTI. Prralla kombtare² (I) (72) /.

VATA (Files): Kur të shof ty turbullohem aqë sa e harroj edhe rrugën /K. JAKOVA : Toka jonë² (14) /.

(Vangjeli) Hapi sytë e mbeti më këmbë *i hutuar aqë sa s'u përgjegj dot* në kohë /MUSARAJ : Isha unë . . . (52) /.

Pozicioni pasfoljor ose pasmbiemëror i korelateve *aq, kaq*, (pozicion mjaft i pazakontë), mungesa e theksimit të sasisë së tiparit a veprimi, si dhe prania e një sasisë të madhe konkrete që në fjalinë kryesore kanë kontribuar për të çvendosur korelatet *aq, kaq* në fjalinë e varur, duke i bashkuar me lidhëzën *sa* në lidhëza të përbëra

17) Presa midis korelatit dhe lidhëzës nuk përfaqëson pauzën etj. midis fjalive; presa është vënë prej autorëve në bazë të sistemit të tyre të pikësimit, të përdorur f. v. për latinishten e gjermanishten.

krejt të njëjta nga funksioni *aq sa, kaqë sa* (e dyta më tepër dialektore) (Cf. it. tanto ché).

Që korelatët *aq, kaq* janë bashkuar me lidhëzën *sa* për të formuar lidhëzat e përbëra *aq(ë) sa, kaq(ë) sa* e tregojnë një varg të dhënash gramatikore, leksiko-gramatikore dhe fonetiko-gramatikore (intonacionore).

Intensiteti a shkalla e shtjellimit të veprimit të foljes kallëzues së fjalisë kryesore ose shkalla e cilësitë së mbiemërit mund të shprehën:

a) me mjete gramatikore: me kundrinën e drejtë të shprehur me emër në kallëzore të shquar pa parafjalë, tërthorazi nëpërmjet të tërësisë së objektit të treguar nga kundrina e drejtë, ose nga një përcaktornjës sasior i kundrinës së drejtë. P.sh.:

Pastaj mori kupën me ujë dhe *ia derdhi* uzos, *aq sa ajo*¹⁸ u turbullua përnjëherësh (...). KOKONA : Me valët e jetës (I).

Me të vërtetë Telo Goxhua *kish ndrequr shumë gjëra* ata gjashtë muaj në kooperativë, *aqë sa nganjëherë qeshte me mendjen e dikurshme* (...). /MUSARAJ : Të shkuara... (63) /.

b) me mjete leksikore, me ndajfolje sasi si *krejt, shumë, plot*, etj. që tregojnë sasi, masë të madhe, P.sh.:

E vërteta është se Pjetri *piu shumë*, *aqë sa iu skuq edhe faqja tjetër*. /GJATA, Armiqtë, «Nëndori», 1964.

Koridori *qe mbushur plot* (,) *aq sa të zihej fryma nga vapa*. / KOKONA : Me valët e jetës (I) (125) /

Ai kishte ndryshuar krejt (,) *aq sa nuk e njihje* (...). /IDEM, Ibidem (284) /.

Shtegu i hapur në mes të borës *ishte shumë i ngushtë*, *aq sa dy vetë nuk mund të kalonin andej krah për krah*. /IDEM, Ibidem (65) /.

c) me një plotësor mënyre që tregon njëkohësisht edhe sasi në saje të kuptimit leksikor të emërit ose togfjalëshit P.sh.

Të vimë nashti te gjysmë njeriu e gjysmë hekuri, që *kyj* (...) *u sëmur më keq*, *kaqë sa nuk munte të ngrihesh*. /DOZON : Manuel (85) /.

/Hajdari) / (...) lëvizi pak duart e shtrenguara mirë me zinxhir, *hapi me forcë pëllëmbët*, *aq sa zinxhiri i u fut thellë në mish* (...). /SHUTERIQI : Çlirimtarët (I) (207) /.

Përyashta *ndihej vishkullima e murlanit qi, me të madhe egërsi*, *kishte ngjatë për tetë ditë rrjesht, me të premë e akull*, *aqë sa gjindja me të madhe përtësë delshin m'ato ditë prej shtepijave* /. /NIKAJ : Shkodra e rrethueme, Bukurusha (225) /.

E donte zonjën e vet për njëmend e me zemër, *aq sa jepte jetën e vet për të* / . / IDEM, Shkodra e rrethueme (49) /.

Bukurusha, në gjithë atë natë, prej andrrave të shumta e të randa *e kishte kaluar keqas gjumin*, *aq sa ma tepër kishte pasë të lodhun se pushim*. /IDEM : Shkodra e rrethueme, Bukurusha (225) /.

ç) me karakterin mohor të kallëzuesit të fjalisë kryesore:

Nuk ndihej asnjë zhurmë (,) *aq sa një urith i nënëdheshëm, nja dy çape larg, filloi të ngrehë një kapule dheu të ronitur si kaçamak*. / ANDONI : Maleve të Shënendre (85) /.

18) Përemri *ajo* është përdorur gabimisht në vënd të përemrit *kjo* (uzua).

Thoshin se /zoti Bardhi/ ish njeri që nuk ia dinte vleftën parasë, aqë sa ngatërronte shpesh herë njëqindfrangëshin me njëzetfrangëshin. /MUSARAJ : Para Agimit, «Nëndori» 1963, N 10 (6) /.

d) nëpërmjet të një fjalie të varur prap nga kryesorja, fjali që tregon mënyrë me anën e sasisë së krahasuar. P.sh.:

Dhe i ra mushkës me sa fuqi që kish, aq sa kafsha mori revan; ndonëse ishte e ngarkuar. /MARA : Shtëpia e Xha Milit (72) /.

dh) me anën e gjithë brendisë së mëparëshme të një periudhe shumëgjymtyrshë P.sh. :

Ishte periudha m'e rrezikëshme. Shumë kishin nisur të dyshonin për zotësin'e Skënderbeut. Nga ana tjetër (,) agjentët e Venetisë dhe të Sulltan Mehmetit II, futnin spica, dhe përndanin më të djathtë e më të mëngjër ryshfete pa kursyer për të blerë kapedanë dhe gjeneralë, aqë sa askush nuk i kishte besim tjetrit. /NOLI : HeS², (78) /

Skënderbeu pasoi taktikën e vjetër, derdhej pa pritur, e përfshinte, e tmerronte, çkatërronte, e lodhte ushtërinë rrëthojëse nga mali i Tumenishtit pa i dhënë prehje as ditë, as natë, aqë sa Sulltan Mehmedi, i mërzhitur dhe i dëshpëruar shkoi nga Kruja më 1 të Gushtit, 1466. /NOLI : HeS² (103) /.

Nga pikëpamja intonacionore, fjalia që prin të varurën rrjedhimore shqyptohet me një ulje mjaft të madhe të zërit në pjesën e dytë, rithmi është i ngadalëshëm, pauza është mjaft e fortë dhe fjalia e varur fillon në regjistër të ulët. Të gjitha këto bëjnë që lidhuria e fjalëve të jetë e dobët, dhe përpara lidhëzave aq(ë) sa, kaqë sa, të vihet në të shkruar jo vetëm presë (e pikëpresë) por ndonjëherë edhe pikë.

— /Dhëndëri është / i mirë që ç'ke me të. Aq sa s'e di cilin dua më shumë: Thanasin që e kam bir apo atë. /KALLAMATA : Netë gjahtarësh (62) /.

Në këtë mënyrë, korelati përemëror aq përbrenda lidhëzës ka humbur kuptimin e dëftimit të sasisë. dhe lidhëza tashmë është e formuar dhe e gjallë.

3. 2. Tipi lidhëzor jokorelativ me lidhëzën kështu që

Ashtu si dhe në shumë gjuhë të tjera indoevropiane, edhe në shqipet disa fjalë që tregojnë mënyrë si *ashtu*, *kështu*, *në* (këtë) *mënyrë*, etj. mund të arrijnë nëpërmjet ndrrimesh semantike të tregojnë rrjedhim (krahaso: rus. *TAK*, it. *così*, angl. *so*, gjerm. *so*, etj.).

Ndajfolja *kështu*, në një kontekst të caktuar mund të tregojë në analizë të fundit një konkluzion, një rrjedhim. Këtë mund ta shohim si në gjuhën popullore, ashtu edhe në letrarishten. Marrim një shëmbull nga Noli.

Sikur të qenë të bashkuar, Shqiptarët mund t'i kishin përballuar me sukses invadorët e huaj.

(1) Po kapedanët patriarkalë të Shqipërisë, posa u çliruan nga zgjedha e huaj, *nisnë të hahen midis tyre*, dhe *kështu* u dhanë rastin armicëve të jashtëm të robërojnë përsëri Shqipërinë e çliruar.

(2) **Kështu** bashkimi i shqiptarëve nënë Balshën dhe Shpatën shkoi mbi qiellin e Shqipërisë si një meteor i ndriçim pas furtunës dhe u çduk... /NOLI : HeS² (10) /.

Fjala *kështu* në fragmentin (I), duke referuar të gjithë fakti i shprehur nga fjalia e nënëvizuar e shndron këtë fakt në një rrethanë të fjalisë «u dhanë rastin armiqve të jashtëmë», etj., rrethanë që merr nuancën e një rrjedhimi. Fjala *kështu* në fragmentin (2) vepron po në këtë mënyrë, duke përmbledhur, përgjithësuar dhe duke nxjerrë konkluzionin e gjithë situatës së mëparëshme.

Në këtë mënyrë, pra, ndajfolja *kështu* mbingarkohet me një nuancë rrjedhimi dhe humb mjaft nga kuptimi i përmë i mënyrës. Ky proces i ka dhënë shkas formimit të lidhëzës rrjedhimore *kështu që*, tek e cila nuanca e mënyrës është shuar, mund të themi, krejt.

Nëndhemi përpara formimit të një lidhëze të re, e cila përdoret rëndom në shkrime të stilit publicistik-shkencor dhe në letërsinë artistike.

Periudha me fjale të varur të bashkuar me këtë lidhëse karakterizohet nga këto tipare:

- 1) Fjalia kryesore s'ka korelat edhe as mund të ketë;
- 2) Fjalia kryesore gramatikusht dhe semantikusht është e plotë.
- 3) Fjalia kryesore nga pikëpamja intonacionore është pothuaj se e mbaruar: ulja e tonit në pjesën e dytë të fjalisë për pak mënt arrin nivelin e një fjalië me intonacione të plotë; megjithëatë ndjehet disi një farë karakteri i pambaruar i saj;

- 4) Fjalia e varur tregon një rrjedhim, një konkluzion që nuk del nga një shkallë e madhe e cilësisë së foljes e të mbiemrit ose emrit a nga sasia e madhe e sendeve që përmenden në fjalinë kryesore, as nga cilësia e ndonjë mbiemri; rrjedhimi del nga tërësia e brendisë së fjalisë kryesore, si një konkluzion objektiv i atyre që janë thënë atje.

- 5) Lidhuria midis fjalisë së varur dhe kryesores është shumë e dobët, aq sa këtu mund të shohim një nga rastet kalimtare të lidhjes nënërenditje-bashkërenditje, por fjalia e dytë nuk mund të quhet akoma e bashkërenditur.

Me këtë sjellje /Skënderbeu/ fitoi dashurinë e ushtarëve, (...) *kështu që* qanin nga mallëngjimi (...). /NOLI : HeS² (40) /.

Çfaqjet jepeshin në një kafe të madhe).

Karrike s'kishte për të gjithë, *kështu që* një pjesë e spektatorëve shtrohej këmbëkryq./ SHUTERIQI: Gurnecka (151) /.

Në ndërmarrjet bujqësore shtetërore ku është bërë një punë e tillë (për përmirësimin e racës së derrave, S. F.), pothuajse derri i vendit ishte zëvendësuar me derra të kryqëzuar, *kështu që* në to prodhimi i mishit ishte i lartë. /E. HOXHA: Mbi masat... (47) /.

Ama atë natë kishin ndenjor vonë, *kështu që* as dy orë gjumë s'i kishim bërë (...). /KALLAMATA : Nete gjahtarësh (77) /.

Latifi ruante për ditë të kijametit nja dy karroqe grurë, po grurin s'i a hanin fëmia, (,), e i leverdisi ta këmbente (me misrin tim. S. F.) (,) *kështu që* misër nga i Meço beut s'kishte vënë në gojë// MUSA-RAJ: Të shkuara... (69-70) /.

Për fat të mirë (,) Ollgës dhomat nuk i rrinin kurrë bosh, *kështu që* kishin një të ardhur të sigurtë./ KOKONA: Me valët e jetës (I) (137) /.

Vasili (rojes) — Besoj se për nga java do të shërohem, *kështu që* do të kemi kohë të bëhemi miq. / I. URUÇI: Doktor Aleks, «Nëndori», 1963, N° 9 (5) /.

Lidhuria e dobët gramatike e fjalisë së varur me kryesoren, karakteri i intonacionit dhe sidomos pauza e gjatë, shkaktojnë që në të shkruar fjalitë kryesore të ndahet jo vetëm me presë, po edhe me pikëpresë, dhe ndonjëherë edhe me pikë.

Gjermanët dinë mirë të sulmojnë dhe të të shtrydhnin për bukuri, por po i vure përpara, gjekundi s'e mbajnë vrapin; *kështu që* e panë punën pisk e nisën me ik të ikim. / ANDONI: Maleve në Shënëndre (96) /.

Evropa ka mundur t'i zhdukë pak nga pak idetë mistike të orientit; *kështu që* rrallë e tek ngjajnë harakirira në Evropën e qytetëruar. / BUKLA: Kur qante e qeshte bilbili (54) /.

Edhe (diplomatët) hanë, pinë e flasin si ne, por kanë një të keqe se flasin shumë, dhe me zë të lartë. *Kështu që* «qeni që leh, nuk të ha». / N. BULKA: Kur qante e qeshte bilbili, (54) /.

Qemali /Thanasit/ — Ua thashë troç: «Kemi humbje. Brenda gjashtëmuorit na del shumë material i harxhuar tepër. *Kështu që* arka e kooperativës ka një humbje të madhe lekësh. / ÇOMORA: Syleshi (51) /

Në mënyrë të tillë janë formuar lidhëza të përbëra rrjedhimore edhe në gjuhën slave, neolatine, gjermanike, etj.

Le të krahasojmë *kështu që* me lidhëzën e rusishtes **ТАК ЧТО ГУМ**. aša cã ital. *cosicché*, angl. *so that*, gjerm. *so dass*; përjashtim bën vetëm frengjishtja, e cila, duke desemantizuar emërat *manière*, façon, *sorte* krijoi lidhëzat e përbëra *de manière que*, *de façon que*, *de sorte que*; me funksion të tillë frengjishtja përdor edhe shprehjet *si bien que*, ose *tant et si bien que*.

3.3. Tipi lidhëzor jokorelativ me lidhëzën në mënyrë që

Lidhëza e përbërë në mënyrë që e ruan akoma kuptimin e mënyrës, ndryshe nga sa ndodh në gjuhën frënge p.sh., ku e ka humbur krejt atë kuptim (me ndonjë përjashtim fort të rrallë).

Periudha me fjali të varur tregon në këtë rast se mënyra e shtjellimit të veprimit të fjalisë kryesore sjell rrjedhimin e shprehur në të varurën. Kjo ndodh kur kallëzuesi i fjalisë së varur është në mënyrën dëftore.

(Këngëtori) ishte fort i ri, po drita i binte në mënyrë që e rrëfente shumë të ngrysur.

Në rast se kallëzuesi i fjalisë së varur është në lidhoren rrjedhimi i fjalisë së varur epet si dikça e synuar, *kështu që* marrëdhëniet e shprehura janë më fort mënyrore-qëllimore.

Të zgjosh interesin tek nxënësi, në mënyrë që ai të kryejë mësimin me qef e vetëdije, ja cila është detyra e mësuesit të vërtetë. / ABDIHOXHA: Një vjeshtë me stuhi.

Lidhëza në mënyrë që është e gjuhës letrare, më fort e stilit publicistik-shkencor.

3.4. Tipi lidhëzor jokorelativ me lidhëzën gjersa

Lidhëza *gjersa*, e përbërë nga parafjala hapësirore-kohore *gjer* dhe lidhëza e sasisë *sa*, përdoret, ndonëse rrallë, në atë rrethana ku përdoret korelati *gjer atje* (shih § 2.5). Më lënien mënjane të ndajfoljes së vendit *atje*, formohet lidhëza *gjer sa* (ose *gjersa*). P.sh. U

zu mulxhiu ynë me fshatarët e Shenkollasit për punën e ujit të vaditjes, puna vajti gjersa të luajë kopaçja. / ANDONI

3. 5. Nentipi lidhëzor jokorelativ me lidhëzën që

Lidhëza që përdoret gjerësisht në gjuhën e folur, në dialog, në fragmente ligjërimore me karakter afektiv, ajo nuk ka dhe nuk mund të ketë në kryesoren (a vartësen) ndonjë korelat. Periudhat me fjali të varur rrjedhimore të këtij nentipi kanë disa karakteristika të veçanta strukturore dhe kuptimore.

3. 5. 1. Fjalja kryesore është pyetëse, gjë që i ve vulën gjithë periudhës, e cila përfshihet e tëra nga intonacioni i pyetjes. Midis fjalive bëhet një pauzë e ndijëshme. Midis fjalive duhet vënë d-mosdo presë.

Ç'u bë dhëndëri (,) që s'del,

moj llokumja me sheqer? / KPLr (146) Përmet /.

Ça ke ba ti, qi je verbue dy sysh? / D. KURTI : Prralla kombtare (I) 61 /

Fjalja e varur përmban një fakt real, i cili bëhet shkas për të pyetur për shkakun e panjohur të këtij fakti real nëpërmjet të fjalisë kryesore.

Tipet përkatëse në disa gramatika të gjuhëve të ndryshme kanë gjetur interpretime pakë të ndryshme. Ferdinand Brynoi¹⁹ pohon se lidhëza «*que* tregon edhe shkakun». Kur shqyrton një periudhë «si kjo më poshtë» *Me prenez-vous pour un païen, que vous ne me croyez capable d'oublier ce que vous avez fait en ma faveur?* «Më merr për ndonjë pagan, që më pandeh të aftë për të harruar ato që kini bërë për mua? S.F.), pohon se «ajo paraqitet si me një interpretim të vështirë. Në vështrim të parë, nuk dihet se ku është shkakun, as ku është rrjedhimi. Po ashtu kur themi: «*Elle était donc vraiment malade dimanche qu'elle est morte* (= Ajo ka qënë me të vërtetë e sëmurë të djelë (,) që vdiq. S.F.). Sigurisht, është sëmundja e personit ajo që shkaktoi vdekjen, ose të paktën e pranojmë se puna është kështu. Sëmundja është pra shkak dhe vdekja — efekt. Por nga ana tjetër, këtu ka një fakt që duhet të vërtetojmë, fakti që ajo ishte sëmurë dhe këtë e nxjerrim nga fakti që vdiq. Kjo fjali përmban motivin që kemi ne për të nxjerrë përfundimin. Ajo ishte sëmurë» (fq. 809). Në gramatikën frënge «Larousse»²⁰ thuhet: «Lidhëza *que*, vetëm, mund të bashkojë një fjali e cila, duke treguar faktin që motivon një pyetje, mund të konsiderohet si një fjali shkakun: *Qu'avez-vous que vous pleurez si fort?* (Ç'kini që qani kaq shumë? S. F.) *Elle était donc fâchée qu'elle n'est pas venue?* ((Mos) ishte zëmëruar ajo që nuk ardhni? S. F.). W. von Wartburg dhe P. Zumthor²¹ janë të mendjes se lidhëza «*que* mer ndonjëherë një vlerë shkakore në një periudhë (phrase) afektive, me ndërtim pyetës ose eksklamativ: «*Est-il malade qu'on ne le voit plus depuis trois mois? Quelle paresse, qu'on*

19) F. BRUNOT: «La pensée et la langue». Troisième édition. Paris 1953, f. 809.

20) «Grammaire Larousse du XX siècle» 17^e tirage. Paris... s. d. f. 110.

21) W. VON WARTBURG et P. ZUMTHOR, «Précis de syntaxe du français contemporain» Seconde édition. Berne, 1958, fq. 96.

ne peut pas même obtenir cela de lui!» Nga ana e tyre R.L. Wagner dhe J. Pichon²² shikojnë në një periudhë të tipit: «*Vous etiez donc parti, qu'on ne vous voyait plus*» një periudhë me varësi të anasjellë (subordination inverse) siç na e tregon titulli i paragrafit § 694 (fq. 583). Autorët janë të mendjes se «shkaku është shprehur në fjalinë e parë» dhe shtojnë se «Nga kuptimi, kjo periudhë me fjali të varur (cette phrase liée) është e baravlerëshme me dy fjali të një periudhe asidetike (deux propositions juxtaposées) si: *On ne vous voyait plus: c'est que vous etiez parti*». Edhe «Gramatika e gjuhës ruse, konstruktet adekuate si да откуда же вы что вы не знаете того, что знают все кучера в городе (Por nga jeni ju, që nuk e dini atë që e dinë gjithë karrocierët e qytetit, S.F.). shpjegohen me faktin se fjalia e dytë përmban atë që dha shkas për pyetjen e shprehur në pjesën e parë të periudhës²³.

Brendia e fjalisë së varur përbën një fakt real që dihet mirë ose është konstatuar prej folësit. P.sh.:

Pasandaj briti mbretëla dhe u thot, që «ç'u bëtë? këtuni!» ... Si erdhi mbreti, hiri mbërnda m² forcë të madhe edhe i thotë mbretë-lës, që «ç'pate, që brite?»/. H. PEDERSEN: Albanesische texte.. Hilet e gravet/.

Ashtu vate djali prapë në shtëpi të tij e ndënji, po rrij sëkëlldisur. I thotë prapë e Bukur e Dheut, që «Ç'ke, që rri sëkëlldisurë tani që më nonjë të keqe nuku ke këtej e tutje, po do keç të mira? / IDEM Ibidem, Kartë për në airet ()/.

E shef Hyrija ashtu mërztshëm e e pvetë:

— Shka ke, more nieri, qi rrin ashtu në mendim?

/D. KURTI: Prralla kombtare² (I) (33) /

Kështu, pra, fjalia e varur nuk përmban shkakun, i cili, në të vërtetë nuk është i pranishëm në periudhë. Brendia e fjalisë së varur, që përmban një fakt real konceptohet prej folësit si një rrjedhim i një shkaku të panjohur prej tij, dhe për atë shkak ai pyet me fjalinë kryesore. Shkaku ndodhet në përgjigjen e bashkëfolësit, kur pyetja ka qënë pyetje e mirëfillët dhe këtë e tregojnë qartë shëmbujt e mëposhtëm.

Mikja ime shamimurgë
del dhe përlozet në rrugë.

«Ç'ke, moj mike, që përloze?»

«Më treti sevdaja jote!» / KPLr (24) jugë /.

— Ç'ke, ti Hekuran, që rri kështu, sikur të ka ngrënë gomari bukën? — e pyeti kryetari.

Kam hallet e mia unë, — çfryjti Hekurani / MUSARAJ
Të shkuara... (51) /.

Ç'ke, kumbarë, qi t'asht marrë zani?

Ma ka zanë tymi i duhanit / KPLr. : Shk. Dy dele e tre-
qind pare /

22) R. L. WAGNER et J. PICHON «Grammaire du français classique et moderne», Paris, 1962, fq. 583.

23) АН СССР Грамматика русского языка, том I; II, часть вторая Москва 1954 fq. 354.

Ç'ke, mor plak, si (= qi, që, S.F.) je thi?

— Nuk jam thi prej pleqnije,

por jam thi prej ashiknije / KPLr. (127) Gjegje (Fand) A

Fjalìa pyetëse mund të jetë edhe e tërthortë (e zhdrejtë), edhe retorike. Kur fjalìa kryesore është pyetëse retorike ajo është baraz me një fjali dëftore mohore, prandaj thenia e fjalisë kryesore mohohet si shkak për rrjedhimin e shprehur në fjalinë e varur.

Karakter i afektiv i pyetjes mund të shprehet edhe me ndonjë fjalë të tillë si *djall*, *dreq* në fjalinë kryesore.

— More, ç'dreqin kanë / fshatarët, S.F. / që fusin kokën, më shohin e ikin pa thënë asnjë fjalë? — thosh me vehte Murat Hasan, KALLAMATA: Netë gjahtarësh (106) /.

Po ç'djall kish xha Telua që s'i bënin duart për punë?

Mos ish plakur e nuk kuptonte? Jo. /MUSARAJ: Të shkuara... 61) /.

Shumë të përhapura janë në gjuhën e folur, në folklor dhe në letërsinë artistike periudhat me një fjali kryesore të shprehur me përemërin pyetës ç (dialektore *çforë*, *çka*, *shka*, *qish* a *çish*, etj.) dhe me foljen *kam* në trajtat e mënyrës dëftore, në kohë të ndryshme (rëndom në të tashmen, të pakryerën, të kryerën e thjeshtë).

E ç'ke që qesh (,) more i paudhë? /MUSARAJ: Të shkuara (19).

— Ç'ke që bëhesh merak, moj e uruar? /ÇOMORA: Syleshi (12) /.

Ç'ke (,) Leze (,) qi vrret — i briti sherbetorja mbas dere / NIKAJ Shkodra e rrethueme (133) /.

/Vajza /... nisë e kjan

— Shka ke — i thotë laroji — qi po kjan? /KURTI: Prralla kombtare (I) (63) /.

Cice, shka ka sot Trinka

qi po priton m'u çue? /MJEDA: Trina, III /.

O, çka që m'u venit qepalla me kaq të ngjethur të pafaj? /L. PORADECI: Lirika (55) /.

Ç'kini, more të mallkuar,

me këtë vënd të bekuar?

Ç'kini ju me shqiptarë,

që doni t'i bëni varrë? /ÇAJUPI: Dhjata e vjetër /.

Zjente lagja e tërë nga kaqë zhurmë edhe gratë dilnin në dera të pyesën.

— (...), Ç'kanë këta fëmijë që thërresën? /KUTELI: Kapllan Aga ... (73) /.

Ç'ka Zolejka që s'gëzon? /ÇAJUPI: Zolejka /.

Ç'ke, moj zemër, që rënkon? Koka bën, koka pëson / Popullore /.

Ç'ka kjo hënë, që nuk më ndahet sonte? /SHUTERIQI: Gurnecka (170) /.

Ky Marku vështroi në sy t'anë dhe e pyeti ç'i kish zemra që pikë-llohej aq fort. /J. XOXA: Novela (II) (89) /.

THANASI: /F. / — Ç'pate që e humbe si Xhaferi? /ÇOMORA: Syleshi (133) /.

Në vështrim të dorës sate ç'pat, o! balli që m'u vdar?

Ç'pat qepall'e përlotuar q'i ra pika tatëpjetë? /L. PORADECI: Lirika (64) /.

Por pyetja nuk mund të bëhet gjithmonë si më sipër vetëm për ndonjë shkak të brendëshëm (ç'ke...) në mënyrë të padiferencuar, por mund të përmbajë pyetje për subjektin, kallëzuesorin, për rrethana të ndryshme (pyetje e pjesëshme) a për vetë veprimin (pyetje e përgjithëshme) dhe kjo epet me përdorimin e përemrave pyetës, mbiemrave përemërorë pyetës; ndajfoljet pyetëse (përveç ndajfoljes përse, pse), si dhe pjesëzat pyetëse (sidomos pjesëza pyetëse e dyshimit mos) dhe me vetë intonacionin e pyetjes, pa ndonjë fjalë pyetëse.

Mos ish faji i shokut Halim dhe i bashkëpunëtorëve të tij (,) që kish akoma mbeturina të tilla në qytet? Jo. Në asnjë mënyrë. /KALLAMATA: Gjëmbat e trendafililit (88)/.

— More, po nuk kini njerës të tjerë (,) që caktoni një njeri në gjithë këto punë? — Kemi, posi! /KALLAMATA: Gjëmbat e trëndafililit (23)/.

— Mor po s'keni tjetër shënjt ju këtej nga Myzeqeja, që të mbet goja tek at Stefani?... — qeshi partizani dhjakun llafazan. /J. XOKA: Novela (II) (6)/.

S'ke frikë pe perëndije, nëneja ime, që më nxjerr plëng'e shtëpije? /MITKO: Bleta shqiptare / Më rrite, baba, më rrite /.

Nuses-o, bylbyl-o,

Kush të thirri qi u përgjigje? /KPLr (212) Shkodër /.

PANDORA: / të panjohurit /: Po zotnija juej kush asht që pyet kaq fort? Mos jeni i policisë? /DUSHI: Banorët... (18)/.

Edhe ashtu/ njerka, S.F./ e mori/ vajzën/ S.F./ gjoja me të mirë e i tha, që «Ç'ish ish sebepi, që u bëre kështu me këto rroba të florimta ti?» / PEDERSEN: Maro Peritura.

— Ç'të keqe të bëra unë, që më le pa strehë? /BULKA: Kur qante... (203)/.

Vullakë, e shkreta Vullakë

u bëfsh tym edhe flakë,

Ç'faj të kanë bërë gratë,

që u le shtresatë thatë /KPLr. Misiri fort i largë /.

Ku paska qenë gjer nashti zotëria e tij që i ka derdhur gjithë fishekët kundër meje dhe s'ka thënë gjysmë fjale për Gori Pishën ose për të tjerë më të zgjuar se Gori, që hedhin gurin e fshehin dorën? /MUSARAJ: Isha unë ... (86)/.

Ku më qe, moj motër (,) si s'em dole zot?

Ku më qe, moj nanë, si s'em dole zot? /KPLr (77) Bardhoc, Kukës /.

— Po zot! Kah hupi Bukurusha, qi nuk ktheu në shtëpi të vetë? tha një tjetër. /NIKAJ: Shkodra e rrethueme (281) Bukurusha /.

QAZIMI: Ene thuj ati kavexhiut si dreqin u bo që s'ma pru hala kaven aj mu. /LEVONJA: Prefekti (15)/.

— Ç'ke, o burrë? Si është puna që po nxiton kështu? — pyeti Qazimeja. /MARA: Shtëpija e xha Milit (73)/.

Periudha e këtij tipi janë shumë të përdorura; ky është nentipi më i përdorur ndër gjithë nentipet lidhëzore jokorelativë.

3.5.2. Fjalia e varur përmban një fakt real që është rrjedhimi i një shkakut të marrë me mend nga ligjëruesi dhe të shprehur në fja-

linë kryesore. Ky tip dallohet nga i mëparëshmi se, si rrjedhimi, si shkak, përmbahen në periudhë, me këtë ndryshim se shkak që shprehet në fjalinë kryesore epet si i marrë me mend, pa ndonjë siguri, P. sh.:

Kush e di ç'intriga dhe komplote bënte Zanafina që e ndau Skënderbeu nga i shoqi i parë; NOLI: HeS¹, Hyrje

Kush e di ç'pabesira dhe tradhësira bënin princët e tjerë që u shtrëngua Skënderbeu t'i aneksonte principatat. /IDEM, Ibidem/.

3.5.3. Një tip tjetër periudhe me fjali të varur rrjedhimore përmban një fjali kryesore mohore ose një fjali thirrrore retorike me kuptim të mohimit me një kallëzuesor të shprehur me mbiemër (ose emër); me fjalinë e varur tregohet se mungesa e cilësisë s'ka si të sjellë rrjedhimin e pritur nga cilësia e shprehur prej mbiemërit a prej emërit.

— S'ke hapur gojë, po dhe matuf nuk ëshë Llazi, që të mos marrë vesh? /MUSARAJ: Isha unë (77)/.

(— Mbaje gojën, ore bej.)

S'kam qënë hyzmeqari yt që të më kërcënohesh. /GJATA: Armiqtë, Nëndori, 1964, Nr. 3 (49)/.

HAJRIJA: Leri ato nashtina e liroja zojës burrin pri burgu.

QAZIMI: Pasi, or jahu ne tina, sa u bon si pula t'burgosmit qi t'dalin aqi kallaj. /B. LEVONJA: Prefekti (51)/.

Kallëzuesi përdoret në lidhoren dhe është tipar i domosdoshëm i konstruktit.

3.5.4. Në tipe të tjera, rrjedhimi mund të jetë diçka e ndryshme nga ajo që pritej të ndodhte, ose është diçka në kundërshtim me synimin, qëllimin e vërtetë. Ndonëse kësi periudhash me fjali të varura kanë elementët strukturorë të periudhës me fjali të varur qëllimore, ato që thuhet në fjalinë e varur nuk përbëjnë diçka drejt së cilës synojmë; me fjalë të tjera në fjalinë e varur nuk kemi një rrjedhim të synuar, të dëshëruar, pra një qëllim, por një fakt që është në kundërshtim me të, që i shmanget synimit të vërtetë.

— Tashti po afron mezi i natës e ti dashke të këndosh që të zgjosh miletin /. /KALLAMATA: Nete gjahtarësh (78)/.

Në këtë shëmbëll, «këngëtori i improvizuar» nuk dëshiron të këndoje me qëllim që të zgjojë «miletin», ai don të këndoje sepse «i këndohet»; me fjalinë e varur «që të zgjosh miletin» folësi i drejtohet «këngëtorit» për t'i treguar se zgjimi i miletit do të jetë një rrjedhim objektiv i këngës në mes të natës, pavarësisht nga dëshira e tij.

— Pastaj më tjetër anë neve do të mos dalëm nga shtëpija ditën që të na vështrojnë, po vetëm natën, kur gjithë njerëzija gjenden në gjumë. /GRAMENO: OXHAKU (14)/.

Dëshirën për të dalë në qytet bashkëfolësi e kundërshton duke objektuar se ka rrezik t'i shohë njeri (ata fshiheshin nga hafijet e beut që i kërkonin nga të katër anët); fjalia e varur mohon rrjedhimin sepse mohohet veprimi i fjalisë kryesore që do të përbente shkakun.

(Tefta — Petritit) — ... I thua vehtes komunist e del si las-kënder pazarit, që të tallen bota me ty. /SHUTERIQI: Çlirimtarët (I).

Unë u zura edhe me nënën, se nuk doja të bëhem nuse (të vishem si nuse gjatë karnavalevet, S.F.), që të tallen pastaj shokët me mua / SHUTERIQI : Gurnecka (43) /.

— Të na vish domosdo në shtëpi, dëgjove? Që sot, bile s'e kemi më as «hanëmin» tani (,) që të druhash. / MUSARAJ : Para agimit, «Nëndori», Nr. 10/1963 (58) /.

Në shembullin e mëposhtmë, gruaja, duke mohuar precedentin — shkak në kryesoren, mohon rrjedhimin e së varurës.

— Po ti, moj grua, nuk do të pish një gotë? (...)

— Mos kam pirë ndonjë natë (,) që të pi sonte? / KOKONA : Me valët e jetës (I) (127);

Si element strukturor i periudhave të këtij tipi është intonacioni i tyre dhe pikërisht ajo anë që ka të bëjë me pauzën; fjalia e varur rrjedhimore ndahet nga kryesorja me pauzë, kurse fjalia qëllimore që varet nga e njëjta kryesore nuk ndahet me pauzë. Në të shkruar duhet të vihet presë gjithmonë.

3.5.6. Fjalisë rrjedhimore i përgjigjet një fjali kryesore që ka në përbërjen e vet elemente leksikore të tillë si *shkak*, *arësye*, etj. Në fjalinë kryesore pohohet leksikisht ekzistenca e një shkakuar-arsyeje për atë që thuhet në fjalinë e varur. Por mund të ndodhë që arsyeja konkrete të mos përmendet, vetëm se afirmohet ekzistenca e saj, por cila është ajo, lihet jashtë periudhës. Kallëzuesi i fjalisë së varur është folje në mënyrën dëftore.

(— Dhe mos ia merr për ters Anesë). *Ka arësytet e saj ajo* (,) që bëhet aqë merak... / MUSARAJ : Para Agimit «Nëndori», 1963, Nr. 10 (25) /.

3.5.6. Fjalia kryesore tregon shkakun e rrjedhimit me mjete leksikore, kurse fjalia e varur është rrjedhimore vetëm nga kuptimi, kurse nga funksioni sintaksor ajo mund të vihej në ekuivalencë me një plotësor përcaktonjës ose me një plotësor kundrinor.

Fjalia kryesore përmban një kallëzuesor të shprehur me emërin *shkak*, *sebe*, (tq. = *shkak*), që i atribuohet kryefjalës me anën e foljes-këpujë (gjysmë këpujë) *bëhem*.

Ay u bë shkak... që shumë fshatarë të flasin keq për traktorin. / SAKO: Ditë të gëzuara (XIV, ...).

Ne bëmë një mbledhje të shpejtë sot për të raportuar nesër, në mbledhjen që ka fshati, punën e kryetarit që s'merret dot vesh as me popullin, as me rininë, që na ka ngatërruar tërë punën dhe është bërë shkak që fshati ynë të mbetet pas të tjerëve / MUSARAJ: Të shkuara... (22) /.

Prikë e shkretë është bërë sebe që shumë vajza të mbeten pa martuar. / KOKONA; Me valët e jetës (I) (84) /.

3.5.7. Fjalia e varur me lidhëzën që pa ndonjë korelat në fjalinë kryesore, mund të bashkojë të varurën drejtpërdrejt me kryesoren duke shprehur rrjedhimin e një sasi e cilësie, por me nuancë efektive, si diçka subjektive, që vlerësohet nga një pikëpamje e caktuar prej folësit (qortim, qesëndi, theksim, etj.). Fjalitë e varura janë nga struktura fjali pyetëse eksklamative, ose thjesht eksklamative; në raste të caktuara mund të jenë dhe mohore, ose pyetëse retorike me vlerën e një fjalie dëftore mohore.

Në këtë tip hyjnë konstrukte mjaft të laryshëm; aty mund të kemi

të tillë që mund të tregojnë një rrjedhim si pasojë e një shkalle të naltë të shtjellimit të veprimit ose të shkallës së naltë të cilësisë, por ndonjë nga korelatët popullorë nuk mund të vihet në fjalinë kryesore, prandaj nuk i përkasin tipit mungesor. Kësi konstruktesh janë tipike për gjuhën e folur popullore dhe për folklorin.

Ashtu si u lodhë që të di, që më takat nuk kishnë, i thot arapi që ... / PEDERSEN: Albanesische texte... Arap Uzengjija (40)/.

Atje nek ai vëndi ishnë dizet hajdut edhe atë vënd e kishnë zap-tuar, që nuku shkonej nonjë njeri andej / PEDERSEN: Albanesische Texte... (51)/

Gomari u këput nga puna që s'mund të mirr këmbët, që të vij. / PEDERSEN: Albanesische Texte... Gluhëtë.

Një zë tjtatër tani dëgjonj,
që zemërnë ma përvëlon,
u doqçë që s'munt të duronj,
bilbili ka zën'e këndon. / NAIM FRASHËRI: LeV: Bilbili /

Mos nxito, cullufepërë, moj mos nxito,
Se kjo udhë ka zahmet-e,
Se vjehrrri të do hyzmet-e,
Kërkon dark'e kërkon drek'e,
Lakruar me dyzet petë.

— Jam e zonja q'i bëj vetë, moj mos nxito,

— Lakruar me dyqint petë, moj mos nxito. / KPLr (196) /.

3.5.8. Në baza të këtij konstrukti, por duke i dhënë fjalisë sunduese një vlerësim afektiv, dalin fjali të varura të cilat përmbajnë, nga përsëritja e shpeshtë, një farë doze formulizimi, për t'u bërë në konstrukte të tjera të ngurosura formula të vërteta, kuptimi i parë i të cilave është zbehur së tepërmi.

Kur u dogj ara (,) / rojtësi / qe në shtëpi, po flinte që prehej. / SAKO: Bereqeti (56) /.

— Tani, që thua ti, me këtë që kemi vënë këtu, i hapet punë fshatit, që do prëhemi. / SAKO: Bereqeti /.

Me punën e breshkës pleqtë shkuan një copë herë që u kënaqën. SAKO: Bereqeti /.

LOKJA: Po, o Met, / Murashi / i regulloi / punët që s'ka ma mirë. / K. JAKOVA: Toka jonë, Akti III) /.

Kemi bërë një gabim të madh, o Meti që lere mos e nga / N. PRIFTI: ÇeF (76) /.

Krisi dyfeku që aman o zot! / KALLAMATA: Nete gjahtarësh (51) /.

Nëpërmjet të një fjalie pyetëse retorike (ç'tu them) me brendi reale mohore, etj. arrijmë fare lehtë te konstrukti formulë që ç'ke me të, në origjinë fjali rrjedhimore, por tashmë të shndrruar në një tog-fjalësh frazeologjik që shpreh rëndom mënyrë.

Po qeshnin e s'qeshnin burrat e botës, që ç'tu them. / SAKO: Bereqeti

— Do të levonjë gërnja që ç'ke me të. / SAKO: Bereqeti (44) /.

(S. — Nejse, xhanëm, ç'na hyn në punë këtu Stefan Lajthija?)

F. Na hyn në punë që ç'ke me të. / DUSHI: Banorët... (8) /.

— /Dhëndëri është / i mirë që ç'ke me të : / KALLAMATA : Netë gjahtarësh (62) /.

Dhe kështu konstrukti që ç'ke me të arriti të kthehet në një formulë të thjeshtë për të treguar ose shkallën e madhe të cilësisë, ose atë të veprimit, sipas konstruktit, pra në një plotësor mënyre ose sasi frazeologjik, në një gjymtyrë fjalie.

Dhe kolovitesha që ç'ke me të. / SHUTERIQI : Gurnecka (6) /.

Po e dhelte e e përkëdhelte që ç'ke me të. / MUSARAJ : Të shkuara (15) /.

(— More burrë, pse s'po e ndjek këtë punë (punën e strehimit, S.F.)

— Po e ndjek, moj grua, që ç'ke me të: Zagar jam bërë / KALLAMATA — Gjëmbat... (58) /.

Aty kishte pasë kenë mbledhë dynjaja e po hajshin e po pijshin e po ia thojshin këngës qi ç'ke me të. / KURTI : Prralla Kombëtare (I) (36) /

— Hej! sa mirë! — thoshte / djalli / me vedi. — Tash po t'i hypi / këtij djalit, S.F. / mbi shpinë qi ç'ke me të. / IDEM, Ibidem (41) /.

3.6. Tipi lidhëzor jokorelativ me lidhëzën tek

Lidhëza tek me këtë funksion përdoret jashtëzakonisht rrallë. Ajo është ngushtësisht diektore. Fjalja e varur ka më fort karakter frazeologjik formule.

Ish i varfër tek më s'bëhet: SHUTERIQI (Gurnecka) /.

4. Periudha me fjali të varur përcaktore në të cilën shprehen nuanca rrjedhimi.

Struktura e fjalisë kryesore në kësi periudhash dallohet nga këto karakteristika:

1) antecedenti emëror shoqërohet nga përemëra dëftorë të cilësisë (kësi, asi, i tillë) të cilët përbëjnë korelatin e përemrit lidhor dhe së bashku me emërin formojnë një togfjalësh emëror-mbiemëror. Prania e korelatit përemëror shkakton një lidhuri shumë të madhe të dy fjalive përbërëse të periudhës; pa fjalinë e varur fjalja kryesore edhe nga pikëpamja gramatikore edhe nga pikëpamja kuptimore mbetet në hava. Fjali e varur është përcaktore — kufizuese. Ky është tipi më i qartë i shprehjes së marrëdhënieve përcaktore me nuancë rrjedhimore.

2) antecedenti emëror nuk është i shoqëruar nga përemërat korelativë, por këta mund të shtihen në fjalinë kryesore, pa sjellë ndonjë ndryshim në marrëdhëniet dhe në nuancën. Lidhuria e fjalive është po aq e madhe si në pikën 1. Antecedenti emëror është gjithëmonë vetëm, i pashoqëruar me ndonjë përcaktor, gjë që për arsye semantike-gramatikore bën që fjalja e varur të jetë pjesë përbërëse e fjalisë kryesore, e gjymtyrës emërore. Antecedenti emëror është rëndom në trajtë të pashquar me një jo shquese / Prania e një jo — shquese (gjysmë shquese një) është tipar gramatikor i domosdoshëm i antecedentit; në rast të kundërt emri, si tregues i një sendi, nuk paraqitet me kuptimin e vet sendor, por me kuptime të tjera (përcaktore a rrethanore).

Fjalja e varur karakterizohet nga prania e përemërit liqnor që (rëndom) që paraqitet më shpesh në funksionin e kryefjalës a të kundrinorit; në rastet e tjera funksioni përemëror i fjalës që zbehet, aq sa të shndërrohet në lidhëzë.

Le të shohim periudhat e tipit 1.

4.1. Ishin rrugë të tilla ato të Qemalit, që nuk të armiqësonin vetëm me familjen tënde, po edhe me njerëzit më të shquar që kishte Shqipëria /MUSARAJ :Përpara agimit, «Nëndori» 10-1963 (63) /.

Përmëri dëftor të tilla në funksion përcaktori ndaj emërit rrugë i ep antecedentit një cilësi në mënyrë më të përgjithëshme, por pa e shprehur atë cilësi; kjo cilësi e pashprehur zbulohet vetëm nëpërmjet të asaj që thuhet në fjalinë e varur, nëpërmjet të rrjedhimit, pasojës së saj. Kjo cilësi mund të merret me mend në çdo rast konkret, nëpërmjet të rrjedhimit të saj. Pikërisht kjo vetijë gramatikore e dëftimit që ka përmëri dëftor i tillë shkakton lidhjen e ngushtë të fjalisë kryesore me fjalinë e varur.

Dëftim cilësie paraqit dhe trajta e rrjedhores e përmëri dëftor ai, ky (asi, kësi, etj.), dhe krijon, sikundër edhe në rastet me korelatin (a) tillë një lidhurë të madhe të fjalive të periudhës. Shëmbull:

— Mos u shqetëso, zonjë, s'është asi djali ai që të hyjë në hakën tënde /MUSARAJ :Para agimit, «Nëndori», Nr. 10/1963 (22) /.

Karakterin e pambaruar të fjalisë kryesore pa atë të varurën na e tregon më së miri periudha e mëposhtme, e cila është ndërprerë prej vetë folësit.

/Leksi /... — Bolshevikët e kanë vështirë, siç e sheh, ia bëri /Leksi /, duke thithë pak bërrnot nga të dy anët e hundës. — Po ata janë një farë e tillë që, po ra në tokë... /SHUTERIQI :Çlirimtarët (I) /.

Cilësia e pashprehur nga korelati përemëror në fjalinë kryesore konkretizohet tërthorazi nga rrjedhimi që sjell ajo dhe që shprehet në fjalinë e varur. Shëmbuj:

Ai fliste me fakte konkrete, tregonte shëmbuj bindës, kishte një arësye të fortë dhe një llogjikë të tillë që i vinte njerëzit si në një mengene dhe s'kishin nga të lëvizin /GJATA :Këneta (373) /.

Leshrat iu lëkundën dhe sytë i muar një shkëlqim të tillë që sikur e ngrohu Colin /SHUTERIQI :Çlirimtarët (I), (81) /.

Dualnë pastaj edhe havaze të tjera, ndërmyjet të cilave kish edhe t'atilla që të ngrinin leshrat përpjetë /MUSARAJ :Para agimit «Nëndori» Nr. 10-963 (62) /.

Pa do të gjindeshin «heronj» të tillë që do ta mbushnin shpinën plot me urdhëra e medalje /KALLAMATA :Netë gjahtarësh (27) /.

2. Grupi i dytë i periudhave me fjali përcaktore me nuanca rrjedhimi përfshin si antecedente emra të pashquar me një joshquese (gjysmë shquese, një, disa) të pashoqëruara nga ndonjë fjalë përcaktuese në përgjithësi. Cilësimi i emrit antecedent bëhet gjithmonë tërthorazi nëpërmjet të rrjedhimit të shprehur në fjalinë e varur.

HAJRIJA /QAZIMIT /: Thue disa llafe tina kaj her' qi ene veshve t'gamcrit i duken t'rona. /B. LEVONJA :Prefekti (46) /.

Cilësia e fjalëve të prefektit, burrit, gruaja nuk e ep, nuk e shpreh si të tillë në fjalinë kryesore; atje ajo vetëm sa na le të kuptojmë se diçka lidhur me cilësinë e «llafeve» do të shprehet më tej.

në fjalinë e varur, dhe nëpërmjet një fakti i cili rëndom është rrjedhim i «një cilësie» të caktuar të llafeve, pra «qi ene veshve t'gamorit i duken t'rona».

Kish ca *opinga* që t'a prishnin mendjen, si ja prishnë e murgut Zyfer. /KUTELI : Nete shqiptare (67) /.

Pastaj / zëri i Resultit / zinte e binte, *me një vajtim* që të drithte mishrat e trupit. /KACORI : Për mëmëdhenë (II) (225) /.

Ju duk profesorit se balli i të gjithëve ndriçoi nga një *gëzim* që s'e kish parë gjer ahëre. /N. BULKA : Skica dhe tregime (16) /.

Në fjalinë e varur përcaktore si përforconjëse e nuancës së rrjedhimit mund të përdoret dhe trajta e foljes *duhet* e cila tregon rrjedhimin si një domosdoshmëri.

-- E kokë, kokë, që duhesh shtypur! — (i) u kërcënua / *vehtes* Hysen Agaj / . / SPASSE : Afërdita përsëri në fshat / IV () /

* * *

5. MËNYRA E KALLËZUESIT TË FJALISË SË VARUR RRJEDHIMORË

Kallëzuesi i fjalisë së varur rrjedhimore mund të jetë një folje në trajta të mënyrës dëftore, lidhore, kushtore, habitore.

5.1. Mënyra më e përdorëshme është dëftorja.

Me foljen kallëzues në dëftore tregohet se rrjedhimi paraqitet si një fakt real. P.sh.:

Xhemili foli kaqë i vendosur sa u *çudit* dhe vetë. /N. PRIFTI : Çezma e floririt (125) /.

Veriu vershonte me tërsëllëm, sa nuk *dëgjonje* të pipëtinjë as juga e detit, as era e Moravës / ANDONI : Maleve në Shënëndre (3) /.

Ai është aq i shkathët, sa *do t'i kryejë* të gjitha.

5.2. Trajtat e mënyrës lidhore kanë një përdorim mjaft të shpesh-të, dhe kushtëzohen a) ose nga vetë modaliteti i fjalisë së varur, b) ose nga qëllimi i thënies së fjalisë kryesore, ose c) nga modaliteti i fjalisë varëse në periudhat trigrjymtyrëshe e lart.

5.2.1. Fjalia e varur shpreh eventualisht, mundësi të kryerjes së veprimit. Kallëzuesi pohor: P.sh.:

Secili prej tyre ish aq i shëtitur nëpër Evropë, sa *ta çmonte* «rrezikun komunist» / SHUTERIQI : Çlirimtarët (I) (241) /.

Po fundi (.), ai ishte aqë i zoti sa t'i a mbyllte gojën këtij inxhinieri plak. / GJATA : Këneta (424) /.

Kur kallëzuesi është mohor, mohohet eventualiteti, mundësia e shtjellimit të rrjedhimit. P.sh.:

ANDONI: Unë kam aq miq sa të mos punoj me kazmë. / URUÇI : Doktor Aleks (259) Nr. 23/1963 (23) /.

QEMALI (...) ish aq i zgjuar sa të mos e hante sapunin për djathë / MUSARAJ : Para agimit «Nëndori», 1963, Nr. 10 (58) /.

5.2.2. Karakteri eventual i shtjellimit të veprimit të fjalisë së varur kushtëzohet nga trajta e së ardhmes së dëftores së kallëzuesit (a këpujës) të fjalisë kryesore.

A *do të jetë* aqë e fortë ajo sa t'i a qëndrojë gjithë këtyre dallgëve? / MUSARAJ : Para agimit «Nëndori», 1963/10 (40) /.

QAZIMI : pluhun kom për t'ju bo t'gjithve sa mos t'u nigjohet emni as për t'mirë e as për t'keq. / LEVONJA : Prefekti (11) /.

Trajta e lidhore së foljes kallëzues në fjalinë e varur mund të kushtëzohet edhe nga folja *mund* si pjesë përbërëse e kallëzuesit të fjalisë kryesore. P.sh.:

Këtu ndër këto pyje shekullore *mund të humbasish* fare shpejt sa mos ta gjejnë as nishanin. / ANDONI : Lufta partizane (149) /.

Kallëzuesi mohor i fjalisë kryesore kërkon përdorimin e lidhore së foljes kallëzues së të varurës.

Trimi shqiptar *nuk ish* aqë *i pamënt* sa të mos marrë vesh se ç'i gjet të mjerëtë vëllezrë (...). / SAMI FRASHËRI : Shqipëria⁷, I, V, (24) /.

Kështu gjithë mbretërit'e mëdha na duan e na nderojnë, edhe miqt'i kemi të shumë, pa nonjë nga këta *nuk* na është aq mik, sa të marrë punënë tënë në dorë, e të përvishetë për këtë punë vetiu / SAMI FRASHËRI : Shqipëria⁷, II, 8 (52) /.

METI: *Nuk ka ra* Leka kaq poshtë (...), sa të gënjejë Tuç Maku në këtë mënyrë. / K. JAKOVA : Toka jonë² (46) /.

SUZANA: Unë flas tamam. Na femnat *nuk jemi* aqë mendjelehta sa t'ju besojmë ju, vetëm me fjalë. / DUSHI : Banorët... (61) /.

Invazionet e përbotme turke (...) *nuk ishin* aqë të parregullta sa të mos peshonin në kandar / NOLI : HeS² (57) /.

Po kështu ndodh edhe kur fjalia kryesore është pyetëse retorike, me vlerën e një fjalie dëftore mohore.

I thotë mbretit: -Ku gjendenë kaqë lëkurë sa të shtrohen të gjitha odat e pallatit?! / PEDERSEN : Albanesische texte: Kartë për n'airet (63) /.

Eventualiteti i kryerjes së veprimit të fjalisë së varur është tipar strukturor i disa tipeve të periudhës me fjali të varur rrjedhimore. Shih paragrafin kur fjalia kryesore ka një korelat frazeologjik, etj.

5.2.3. mënyra e foljes kallëzues së fjalisë së varur varet nga mënyra e foljes kallëzues të fjalisë sunduese: kur kjo e ka kallëzuesin në lidhore edhe fjalia e varur përdor lidhoren. Periudha është së paku trigjymtyrshë. Këtu kemi një shprehje të varësisë gramatikore nëpërmjet të pajtimit të mënyrës:

— Më lerë, dua të *qaj* sa të enjtem — (...). / GJATA : Këneta (154) /.

Kam të drejtë të *thërres* sa të zgjonj edhe xhindet nga gjumi. / IDEM, ibidem, (64)?.

A të kam thënë se do të të shpije në Tiranë, *që të bësh qejf* sa ta mbash mend gjersa të vdesësh?! / GJATA : Armiqtë, «Nëndori», 1964, Nr. 3 (32) /.

Në shëmbullin e mëposhtmë trajta e së pakryerës së lidhore të *jetonte* është përdorur për arsye se në fjalinë vartëse kemi trajtën *do të fitonte* që tregon veprim të ardhmë ndaj një veprimi tjetër të së shkuarës (*shpresonte*).

Aso kohe ai shpresonte se me fuqinë e krahëve të veta *do të fitonte* aqë para sa të jetonte në një shtëpi të re si ajo e drejtorit të fabrikës. / A. ABDIHOXHA : Një vjeshtë me stuhi (183) /.

5.3. Vlerën e një veprimi të ardhëshëm ndaj një tjetri të kaluar ka trajta homonime e kushtores jo vetëm kur periudha nuk është

trigjymtyrëshe, si më sipër, dhe kemi ligjëratë të tërthortë të mirëfillët, por edhe kur kemi ligjëratë të tërthortë të pamirëfillët, ose ligjëratë të tërthortë të lirë (discours indirect libre, несобственно прямая речь në periudhën dygjymtyrëshe. Kjo është trajtë e dëftores.

Jo nuk mund të diktonin.

Ai i kishte bërë planet aqë bukur, sa asnjëri nuk do të dyshonte / GJATA : Këneta (424).

Kallëzuesi mund të përdoret në trajtë të kushtores në rast se në fjalinë e varur shprehet një kusht. Kjo ndodh kur periudha është së paku trigjymtyrëshe dhe fjalia e varur rrjedhimore është vetë fjali kryesore për fjalinë kushtore, e cila është fjali e varur e shkallës së dytë. P.sh.:

/ Djali dhe vajza / Ishin aq afër njeri tjetrit, sa po të qe natë, me siguri do të përqafoheshin. / GJATA : Tana¹, 1/.

Turqit e drejtuan tërë forcën kundër qëndrës shqiptare, dhe sulmet e tyre të përsëritura qenë aqë të tërbuara sa do ta kishin thyer, sikur të mos ndodheshin atje Skënderbeu dhe Ajdini/NOLI : HeS² (83) /.

Po truri i tij qe aq i lodhur, sa që kurrë nuk do ta kishte sjellë ndër mend, po të mos i kish dhënë ay vetë të njohur. / KACORI : Për mëmëdhenë (1) (93) /.

Në trajtën e kushtores vihet kallëzuesi i fjalës së varur rrjedhimore edhe kur kjo është njëkohësisht fjali kryesore për një fjali të varur lejore-kushtore. P.sh.:

(...) ajo drej grua ca e kish zërin të lartë e ca thërriste vetë, që edhe i shurdhër fare të ish, (plaku) do ta kish dëgjuar / GJATA : Tana², (66) /.

5.4. Jashtëzakonisht rrallë përdoret kallëzuesi në mënyrën habitore — (Lere, or bir, atë muhabet). Na paskan gënjyer sa na paskan shuar. / KALLAMATA : Netë gjahtarësh (64) /.

5.5. Kallëzuesi i fjalisë së varur përdoret në urdhërore vetëm kur fjalia e varur është shndrruar në një formulë. P.sh.:

E kryenë kaq mirë që lere mos pyet.

6. PERIUDHA E PËRBËRË ME FJALI TË VARUR RRJEDHIMORE

Periudhë e përbërë quajmë një periudhë që ka dy ose më shumë fjali të varura ose dy a më shumë kryesore dhe periudhë e përbërë me fjali të varura rrjedhimore atë që ka së paku një fjali të varur rrjedhimore dhe të tjerat kryesore, ose një fjali kryesore dhe të tjerat fjali të varura rrjedhimore.

Do të dallohen këto raste:

6.1. Në periudhën e përbërë ka një fjali kryesore dhe dy ose më shumë fjali të varura rrjedhimore. Sipas lidhjes së fjalive të varura me kryesore dallojmë dy raste:

6.1.1. Fjalitë rrjedhimore varen nga po ajo fjali kryesore dhe janë të bashkëvarura homogjene.

Ardhja e ushtërisë shqiptare nënë një kumandar të dëgjuar në tërë botën e tmerroi ushtërinë rrethonjëse aqë shumë sa Konti Piccinino e ngriti rrethimin e Barletës me vrap edhe u hoq tridhjetë mila më tutje. / HeS², (91) /.

Fjalitë e bashkëvarura janë bashkuar midis tyre me lidhëza bashkërenditëse; lidhëza nënërenditëse e rrjedhimit përdoret vetëm një herë dhe nuk përsëritet përpara fjalive të tjera rrjedhimore. Fjalitë e bashkëvarura nga e njëjta gjymtyrë e kryesores vendosen njëra pas tjetrës.

Me këto të këqija pra, i hyri një ah aqë i madh djallit, sa i u mërzit vetëheja e atij, e s'e donte më të gjallët. /MITKO : Bleta Shqipëtare /.

Dhe bëjnë aqë shumë atje dardhat, sa hanë njerëzija dhe ngopen bagëtija. /SHUTERIQI : Gurnecka (26) /.

Errësira ish aq e madhe, sa tjetri mund të të fuste gjishtrinjtë në sy e ti të mos e shihje fare. /DUSHI : UeV, (XI,2) /.

6.1.2. Nga disa gjymtyrë të së njëjtës fjali kryesore varen dy ose më shumë fjali rrjedhimore. Gjymtyrët e fjalisë kryesore duhet të jenë homogjene, dhe nga numuri i tyre varet edhe numuri i fjalive të varura rrjedhimore. Ky numur teorikisht mund të jetë mjaft i madh, por në praktikë nuk gjejmë më shumë se dy fjali rrjedhimore që të varen nga gjymtyrë homogjenë të kryesores. Çdo fjali ndjek gjymtyrën përkatëse që plotëson, kështu që fjalia rrjedhimore e parë hyn në mes të kryesores, kurse ajo e dyta vjen pas saj. P.sh.:

Më të hyrë të kooperativës ka një rrap të madh, të moçëm sa s'mbahet mënd, me një trung të trashë sa as dy veta nuk mund ta pushtojnë dot. /GJATA : Tana¹, (1...).

Ky tip periudhe përdoret rrallë.

6.2. Fjalitë rrjedhimore janë lidhur me vartësi varg, domethënë fjalia rrjedhimore e shkallës së parë varet drejtpërdrejt nga fjalia kryesore, kurse fjalia e dytë varet nga fjalia rrjedhimore e shkallës së parë. Shëmbujt që disponojmë tregojnë se në këtë lloj varësie nuk shkojmë përtej fjalisë së varur rrjedhimore të shkallës së dytë, ndonëse struktura ep mundësi për më shumë; kjo do të thotë se shkrimtarët tanë nuk kanë shfrytëzuar gjithë mundësitë që apin lidhjet e fjalive rrjedhimore në periudhë. Përpara çdo fjalie të varur përdoret domosdo lidhëza. P.sh.:

(Dashuria) i shastiste dhe i dehte njerëzit kaq shumë sa ata jetonin për disa çaste në një botë tjetër, në mes të një lumtërie kaq të plotë sa njeriu e humbiste fare ndjenjën e kësaj jete. /KOKONA : Me valët e jetës (I) (96) /.

Ç'kishte ndodhur vallë që ish-in zgjeruar aq shumë horizontet sa prej asaj dritareje dukej edhe një rryp deti, atje tej, shumë larg, poshtë bregores e pllajave zbuluar me blerim të errët. /GJATA : Armiqtë — Nëndori Nr. 1/1964 (18) /.

Fjalia e varur rrjedhimore nuk mund të qëndrojë para kryesores.²⁴

Me qënë se fjalia rrjedhimore nuk qëndron dot përpara kryesores dhe fjalitë janë bashkuar me vartësinë varg, fjalitë e periudhës së

24) Është krejt e gabuar thënia që përsëritet nga një tekst sintakse në tjetrën (b. f. në atë të Rrotës, Domit, Priftit), se fjalia e varur rrjedhimore mund të qëndrojë para kryesores. Faktet gjuhësore të shqipes e hedhin poshtë këtë thënie.

përbërë ndjekin njëra tjetrën: në fillim — kryesorja, pastaj rrjedhimorja e shkallës së parë, pastaj ajo e shkallës së dytë.

Fjalja rrjedhimore mund të varet nga dy ose më shumë fjali kryesore, të bashkërenditura midis tyre me lidhëza këpujore, ose të bashkuara palidhëzorisht, asindetisht. Fjalja e varur plotëson njëkohësisht që të gjitha fjalitë e bashkërenditura kur zë vendin e fundit në periudhë. P.sh. :

Po viktoria përpara Beratit ishte aqë e papritur, edhe tmerri nga emri i Skënderbeut ish aq'i math, sa Evrehozi i urtë (...) nuk vajti më tutje (...). /NOLI : HeS², (77) /.

Tefta e ndjeu vehten kaq të turpëruar, ajo e ndjeu kaq të rëndë atë poshtërim, sa mendja i u err. /SHUTERIQI. Çlirimtarët (II), (IV-5) /.

Lidhjet sintaksore të fjalive rrjedhimore dhe atyre kryesore në periudhën e përbërë mund të kombinohen, por grupet kompakte të fjalive në periudhën e përbërë me fjali të varura rrjedhimore, siç na tregon materiali i shqyrtuar, janë relativisht të kufizuara nga numuri i përbërësive: nuk kemi më shumë se dy fjali kryesore të bashkërenditura nga të cilat bashkëvaren më shumë se dy fjali rrjedhimore të bashkërenditura. P.sh. :

Por vise-vise pemët ishin aq afër e afër dhe degët e tyre aq të ngatëruara sa jo vetëm nuk mund të kalonje po as rrezet e diellit nuk hapnin atje shteg. /A. MARA : Shtëpia e xha Milit (60) /.

(...) nga skapamentua e karakatinës u dëgjuan krisma kaq të forta dhe doli një tym kaq i madh, sa që u trondit pazari dhe njerëzit (...) u zhdukën nga sytë e delegatëve. /KALLAMATA: Nete gjah-tarësh (40) /.

Në këtë shëmbullin e fundit vendosja e fjalive rrrjedhimore ndaj kryesoreve të bashkërenditura duhej të ishte bërë pakëz ndryshe, duke vënë përpara çdo fjalie që tregon rrjedhim një fjali që tregon shkak; periudha duhet të kishte këtë renditje.

Nga skampamentua e karakatinës u dëgjuan krisma kaq të forta sa që u trondit pazari dhe doli një tym kaq i madh sa njerëzit u zhdukën nga sytë e delegatëve.

Ashtu siç i ka vendosur autori fjalitë rrjedhimore, del se tronditja e pazarit dhe zhdukja e njerëzve nga sytë e delegatëve ishte pasojë njëherazi edhe e krismës, dhe e tymit, gjë që nuk i përgjigjet realitetit të situatës konkrete.

6.3. Në një periudhë më të ndërlikuar mund të kemi dy grupe fjalish, dy periudha me fjali të varur rrjedhimore: një periudhë të thjeshtë (të përbërë prej një kryesoreje dhe prej një rrjedhimoreje) dhe një periudhë të përbërë, të bashkuar midis tyre me lidhëza bashkërenditëse. Një model mjaft interesant na e ep krijimtaria popullore gojore. P.sh. :

Një herë ndë një kohë frijti një erë kaqë e fortë, sa tundi detinë nga fundi, edhe deti kërreu një gjarpënë kaqë të madh, që kish sitë baraj me një sini, edhe kaqë të trashë, sa me zi ta përciellnë dhjetë shpirt (njerëz). /PEDERSEN : Albanesishe texte (Besime popullore, 18) /.

KONKLuzion

Periudha me fjali të varur rrjedhimore paraqitet në shqipen e sotme me tipe semantiko-strukturore krejtësisht të formuara dhe që veprojnë në stilet e ndryshme të gjuhës.

Prania e një numuri mjaft të madh korelatësh të lidhëzave *sa* dhe *që* ep mundësi për të bërë më mirë diferencimin e marrëdhënieve dhe nuancave në periudhë; këta korelatë janë gjërësisht të përdorur jo vetëm në gjuhën e shkruar, por edhe në gjuhën e folur, dhe vetëm në konstrukte me karakter afektiv mund të gjejmë fjali kryesore pa korelatë të lidhëzës (tipi korelativ mungesor lidhëzor përemëror) dhe në disa nëntipe të tipit lidhëzor jokorelativ, tek të cilat lidhëza *që* nuk mund të ketë korelat në kryesoren.

Nga ana tjetër, struktura e periudhave me fjali të varur rrjedhimore është perfeksionuar më tej nëpërmjet të krijimit të lidhëzave të përbëra me kuptim të përcaktuar dhe me sferë përdorimi të ravijëzuar qartë: *kaqë sa, aq sa; kështu që, në mënyrë që; lidhëzat kaq(ë) sa, aq sa*, tek të cilat ndajfoljet përemërore *kaq, aq*, ish-korelatë, janë shndruar në pjesë përbërëse të lidhëzës duke humbur thuajse krejt kuptimin e përmë të tregimit të sasisë. E afërme nga kuptimi është lidhëza e përbërë *kështu që*, e cila e tregon rrjedhimin pa ndonjë nuancë anësore të sasisë, cilësisë ose mënyrës, por si një konkluzion logjik i gjithë brendisë së fjalisë kryesore. Lidhëza e përbërë, relativisht e re, *në mënyrë që* e përdorur si dhe lidhëza *kështu që* në stilin publicistiko-shkencor e tregon rrjedhimin nëpërmjet të mënyrës së shtjellimit të veprimit të fjalisë kryesore me kusht që kallëzuesi i fjalisë së varur të jetë folje në dëftore, ndërsa po kjo lidhëzë, e përdorur në një fjali të varur me foljen kallëzues në lidhore arrin të shprehë qëllimin (rrjedhim të synuar).

Tipi përcaktor me nuancë rrjedhimore përbën një tip krejt anësor, ku treguesat kryesore semantiko-strukturorë janë të periudhës me fjali të varur përcaktore dhe vetëm korelacioni i përmbajtjeve reale konkrete arrin të apë një nuancë rrjedhimi pak a shumë të qartë.

Prania e një vargu korelatësh të mjetit të lidhjes (lidhëzave), prania e disa lidhëzave të thjeshta dhe të përbëra, mekanizmi i mënyrëve dhe kohëve të foljeve kallëzues si dhe vetitjat intonacionore e bëjnë periudhën me fjali të varur rrjedhimore të shqipes së sotme një konstrukt të ngulitur dhe të shkathët, i cili qëndron në një nivel me konstruktet adekuate të gjuhëve më të përparuara indoevropjane — neolatine, gjermanike, slave, etj.

LISTA E VEPRAVET

- ANDONI S. Lufta partizane. T. 1959.
- ANDONI S. Maleve në shënëndre. T. 1958.
- ANDONI S. Tregime nga Morava. T. 1960.
- ABDIHOXHA A. Një vjeshtë me stuhi. T. 1958.
- BULKA N. Kur qante... (Bota siç ish kur qante dhe qeshte bilbili, Red. M. Gurakuqi). T. 1962.
- ÇAJUPI Vepra. Red. Dh. Shuteriqi. T. 1957.
- ÇOMORA S. Syleshi. T. 1958.
- DINE S. VeD (Valët e detit) Sofie
- DOZON. A. Manuel... (Manuel de la langue chkiye au albanaise, Paris, 1878).
- DUSHI K. UeV (Udha e Velanit. T. 1955).
- DUSHI K. Banorët (Banorët e shkallës N° 6, T. 1965).
- FRASHËRI N. HeS (Histori e Skënderbeut, Red. Prof. K. Cipo. T. 1953).
- FRASHËRI N. LeV (Lulet e verës, Red. Sh. Demiraj. T. 1956).
- FRASHËRI S. Shqipëria⁶... (Shqipëria ç'ka qënë, ç'është dhe ç'do të jetë. Botim i gjashtë. Botonjës Luarasi. T., pa datë)
- FRASHËRI S. Shqipëria⁷... (Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhetë. Red. K. Frashëri — Sh. Demiraj. T. 1962).
- GJATA F. Këneta. T. 1959.
- GJATA F. Përmbysja. T. 1954.
- GJATA F. Tana¹, T. 1955.
- GJATA F. Tana², T. 1959.
- GJATA F. Armiqtë, in «Nëndori» N° 1,2,3, 1964.
- GJEÇOV SH. KiLD (Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shkodër, 1933).
- GRAMENO M. Oxhaku.
- HOXHA E. Mbi masat... (Mbi masat që duhen marrë për shtimin me ritëm të shpejtë të prodhimit të mishit dhe të qumështit. T. 1958).
- INSTITUTI I SHKENCAVET KPLr (Këngë popullore lirike, T. 1955).
- JAKOVA K. Toka jonë². T. 1961.
- KACORI TH. Për mëmëdhenë (I). Vëllimi i parë. T. 1961.
- KACORI TH. Për mëmëdhenë (II). Vëllimi i dytë. T. 1963.
- KALLAMATA M. Gjëmbat e trëndafilit. T. 1955
- KALLAMATA M. Nete gjahtarësh. T. 1959.
- KOKONA V. Me valët e jetës (I) vëllim i parë, T. 1961.
- KURTI D. Prralla kombëtare² (I) Ble I, Shkodër 1942.
- KURTI D. Prralla kombëtare² (II) Ble II, Shkodër 1943.
- KUTELI M. Kapllan Aga... (Kapllan Aga i Shaban Shpatës, T. 1944).
- KUTELI M. Nete shqiptare. T. 1944
- LEVONJA B. Prefekti. T. 1961.
- MAËRA A. Shtëpija e xha Milit. T. 1955
- MARKO P. Hasta la vista. T. 1958.
- MIGJENI Vepra. Red. S. Luarasi. T. 1957.
- MITKO TH. Bleta shqiptare. Wien 1922.

- MUSARAJ SH. T, shkuara — të paharruara. T. 1958.
 MUSARAJ SH. Isha unë Çobo Rrapushi. Llaz Qestorati. T. 1960.
 MUSARAJ SH. Para agimit. In «Nëndori» N°10 e 11, 1963.
 NOLI F. HeS¹ (Historia e Skënderbeut. Boston, 1921).
 NOLI F. HeS² (Historia e Skënderbeut. Boston, 1950).
 NOLI F. Parathënia e përkthimit të veprës «Tragjedia e Othellos» Botim i dytë. Tiranë 1960.
 NOLI F. Introdiktë në përkthimin e tragjedisë «Makbethi». Botim i dytë. T. 1957.
 NOLI F. Parathënie e përkthimit të «Hamleti»-t të Shekspirit. Botim i dytë. T. 1960.
 NIKAJ N. Shkodra e rrethueme. Bukurusha. Red. R. Brahim. T. 1961.
 PEDERSEN H. Albanesische texte... (Albanesische texte mit glossar, Leipzig 1895).
 POËRDECI L. Lirika. Red. M. Xhaxhiu. N. Sh. B. Naim Frashëri, pa veqnd, pa datë.
 POSTOLI F. LeK (Lulja e Kujtimit, T. 1957).
 PRIFTI N. ÇeF (Çezma e floririt). T. 1960).
 SAKO Z. Bereqeti. T. 1951.
 SAKO Z. Ditë të gëzuara. T. 1953.
 SINAERI N. Kokrra aguridhe. T. 1959.
 SPASSE S. Ata nuk ishin vetëm... T. 1952.
 SPASSE S. Afërdita përsëri në fshat T. 1955.
 SHEHU M. Lufta për çlirimin e Tiranës². Botimi i dytë. T. 1959.
 SHUTERIQI DH. Çlirimtarët (I). Libër I. T. 1952.
 SHUTERIQI DH. Çlirimtarët (II). Libër II. T. 1954. (kop. 1955)
 SHUTERIQI DH. Gurnecka. T. 1957.
 SHUTERIQI DH. KeP (Kënga e pushka. T. 1963).
 URUÇI I. Doktor Aleks. In «Nëndori» N° 8, 1963.
 UNIVERSITETI Fjalë të urta të popullit tonë. T. 1958.
 SHTETËROR I
 TIRANËS
 XOXAJ J. Novela (II). T. 1958.

Résumé

LA PHRASE COMPLEXE A SUBORDONNÉE CONSEQUENTIELLE EN ALBANAIS CONTEMPORAIN

L'auteur fait l'étude de la phrase complexe comprenant une proposition conséquentielle (consécutives) d'après les matériaux assez abondants de la langue écrite et du folklore albanais depuis La Renaissance albanaise jusqu'à nos jours. Il classe les phrases complexes a subordonnée conséquentielle dans trois groupes sémantico-structuraux, dont deux principaux, consécutifs proprement dits, et un troisième à nuance conséquentielle supplémentaire.

1) Le premier groupe comprend le type conjonctionnel-pronominal corrélatif, dont les propriétés sont les suivantes: la conjonction *sa* (= it. *quanto*) qui introduit la subordonnée a dans la principale un mot

corrélatif, un intensif: kaq(ë), aq(ë) (= tant), adverbess pronominaux déterminant un substantif (et dans ce cas fonctionnant comme un adjectif), un adjectif, un adverbe, mais très rarement un verbe situés dans la principale. A la conjonction sa peuvent correspondre en qualité de mots corrélatifs l'adverbe mjaft (= assez), l'expression gjer atje (deri atje) (à tel point, mot à mot jusque là), le pronom démonstratif ky, ai, (= celui-ci, celui-là) dans l'expression gjer në atë pikë (à un tel point, mot à mot jusqu'à ce point) et dans l'expression më këtë ditë, më atë ditë (qui équivaut au fr. dans un tel état). A la conjonction simple që (que) correspondent les mots corrélatifs shumë (= beaucoup, dans le sens de trop), tepër (= trop,) les mots marquant la suffisance mjafton (il suffit), është mjaft (il est suffisant), et surtout le pronom i tillë (tel), pouvant se présenter comme épithète (anteposée ou postposée au nom) ou bien comme attribut: le corrélatif i tillë est surtout caractéristique pour la langue écrite. Si le mot corrélatif i tillë renvoie à un mot qui par son sens lexical comporte une nuance de quantité, la subordonnée peut être introduite aussi par la conjonction sa, à ce qui paraît, par suite d'une contamination de structure. L'auteur analyse aussi les divers éléments de structure, la position du corrélatif par rapport au mot déterminé, l'intonation de la phrase, ainsi que les diverses nuances de conséquence. L'auteur souligne l'étroite connexion de la subordonnée à la principale, du point de vue grammatical et de signification. Le soustype corrélatif conjonctionnel-pronominal élliptique, quoique encore bien représenté dans la langue parlée, montre une tendance vers un emploi toujours plus fréquent des mots corrélatifs.

2) le deuxième groupe comprend les constructions sémantico-structurelles conséquentielles dy type conjonctionnel noncorrélatif, qui diffère des constructions du premier groupe parce que à la conjonction (locution conjonctive) qui introduit la subordonnée de conséquence ne peut pas correspondre aucun mot corrélatif dans la principale; le lien de la subordonnée et de la principale est plus lâche, du point de vue grammatical et de signification, ce qui est appuyée par une pause très sensible entre les propositions, etc. Les divers sous-types sont introduits par la conjonction simple që (que) ou bien par des locutions conjonctionnelles kaq(ë) sa, aq(ë) sa (comparez en it. tanto chè), formées par le passage des adverbess kaq(ë), aq(ë), entièrement désémantisés, dans la proposition subordonnée, locutions conjonctionnelles populaires et fort représentées dans tous les styles (à l'exception du style poétique). La locution conjonctionnelle kështu që, formée par la conjonction që précédée de l'adverbe de manière à nuance conséquentielle kështu (ainsi) a la même structure que les locutions correspondantes italienne cosicché, russe так что, anglaise so that, allemande so dass et indique une conséquence «pure» est assez largement employée dans le style publicistique et savant. La locution conjonctionnelle në mënyrë që (+ verbe à l'indicatif) garde encore la nuance de la manière (nuance qui dans le français contemporain est presque disparue). La conjonction që, employée largement dans le langage affectif, dans les phrases complexes à une principale interrogative (totale ou partielle, proprement dite ou bien rhétorique) introduit une subordonnée marquant la conséquence comme découlant d'un fait-cause comprise dans la réplique de l'interlocuteur, ou bien d'un fait-cause sous-entendue ou bien simple-

ment soupçonnée, et d'autres nuances très vives a valeur affective (3.5.). La conjonction *gjersa* (*deri sa*), équivalente aux locutions françaises au point que, à tel point que (mot à mot jusqu'à ce que) exprime un fait comme la conséquence du degré extrême du développement de l'action de la principale et s'emploie plus rarement que les conjonctions précédentes. L'absence des mots corrélatifs, les différences de structure, d'intonation et de signification sont examinés en détail par l'auteur. Les subordonnées marquant en général une conclusion, une déduction logique du contenu de la principale, sont appuyées très lâchement à la principale, ce qui est mis en relief par une pause très sensible.

3) Le troisième groupe constitue un groupe à part: les subordonnées, de construction relative (relatives explicatives), ont une nuance supplémentaire latérale de conséquence, qui découle uniquement de la corrélation des contenus réels concrets des propositions de la phrase complexe. La subordonnée est introduite par le pronom relatif *që* (qui).

Dans la partie 5 l'auteur analyse les modes du verbe de la subordonnée et leurs acceptions, tandis que dans la dernière partie,⁽⁶⁾ il examine les phrases à deux ou bien plus de principales et subordonnées, montrant les conditions d'agencement des subordonnées entre elles et avec la principale, etc., concluant que dans l'albanais la conséquentielle peut être ou bien interpositive, ou bien postpositive par rapport à la principale, la préposition étant exclue.

